

RAPORT

I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Për Programin e studimit “Master i shkencave” në “Administrim Biznesi”, me profile: “I Përgjithshëm”, “Menaxhim”, “Menaxhim i Burimeve Njerëzore”, “Marketing”, “Menaxhim i Sistemeve të Informacionit”, “Bankë”

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Prof. As. Arlinda Ymeraj

Prof. Dr. Raimonda Duka



Shtator, 2019

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit “Master i shkencave” në “Administrim Biznesi”, me profile: “I Përgjithshëm”, “Menaxhim”, “Menaxhim i Burimeve Njerëzore”, “Marketing”, “Menaxhim i Sistemeve të Informacionit”, “Bankë”

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Universiteti i New York-ut në Tiranë
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit / Departamenti i Administrim Biznesit
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	UMASH Nr. 618, datë 26.12.2011 ¹
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	UMASH Nr. 384, datë 06.09.2013 ² / VKA Nr. 508, datë 18.07.2013
5	Titulli i programit të studimit:	“Master i shkencave” në “Administrim Biznesi”, me profile: “I Përgjithshëm”, “Menaxhim”, “Menaxhim i Burimeve Njerëzore”, “Marketing”, “Menaxhim i Sistemeve të Informacionit”, “Bankë”
6	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike
8	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Anglisht
11	Programi ofrohet nga institucioni	PO
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	JO
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	JO
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	JO
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli 7
16	Aktivizimi i programit të studimit	2011-2012
17	Numri i studentëve	46 studentë

¹ Ky është dokumenti i riorganizimit nga “Master i Nivelit të Parë” në “Master i shkencave”. Programi është hapur fillimisht me VKM Nr. 256, datë 27.02.2008 (MNP për: “Administrim Biznesi”; “Administrim Biznesi me profil Bankar”)

² Kurse akreditimi i MPN është bërë me UMASH Nr. 161, datë 18.03.2010 / VKA Nr. 67, datë 26.02.2010.

HYRJE

Të dhëna për programin e studimit “Master i shkencave” në “Administrim Biznesi”, me profile: “I Përgjithshëm”, “Menaxhim”, “Menaxhim i Burimeve Njerëzore”, “Marketing”, “Menaxhim i Sistemeve të Informacionit”, “Bankë”

Universiteti i New York-ut e ka filluar veprimtarinë e tij në vitin 2002. Ai u licensua me VKM nr. 397, datë 15.08.2002, me anë të të cilit u lejua të ofrojë programe studimi të ciklit të parë në disa profile të Shkencave Ekonomike, Shkenca Kompjuterike dhe Gjuhë dhe Letërsi Angleze. PS Master i Shkencave në Administrim Biznes fillimisht është zhvilluar mbi bazën e programit të MBA, që u çel në vitin 2004 i licensuar me VKM nr. 256, datë 27.02.2008. Programi MBA u akreditua nga MASH me Urdhërin Nr.161, datë 18.03.2011 dhe më pas u ristrukturua që të përmbushte kërkesat e programit të studimit Master Shkencor.

Programi Msc në Administrim Biznesi me profile operon në mënyrë të pandërprerë prej vitit 2011. Programi i studimit është licensuar me UMASH Nr. 618, date 26.12.2011 dhe akredituar për herë të parë me UMASH Nr. 384, datë 06.09.2013, mbështetur në vendimin Nr. 508, datë 18.07.2013 të Këshillit të Akreditimit.

Programi i studimit Msc në “Administrim Biznesi” me profile ofrohet nga Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit. Ky fakultet ofron gjithashtu programe studimi të ciklit të parë dhe ciklit të tretë. Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit përbëhet nga 2 departamente (Departamenti i Financës dhe Ekonomiksit, Departamenti i Administrim Biznesit) dhe 1 qendër kërkimore (Qendra Kërkimore për Ekonominë dhe Biznesin). Programi është konceptuar me gjashtë profile:

1. Master Shkencor për Profilin e Përgjithshëm
2. Master Shkencor në Menaxhim
3. Master Shkencor në Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
4. Master Shkencor në Marketing
5. Master Shkencor në Menaxhimin e Sistemeve të Informacionit
6. Master Shkencor në Bankë

UNYT u riorganizua në vitin 2017 dhe përbëhet aktualisht nga tre Fakultete: Fakulteti i Ekonomisë, Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale, dhe Fakulteti i Informaticës, mbështetur në Urdhëresën Nr. 288, datë 22.05.2017. Univesiteti u riakreditua institucionalisht nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, me vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 102, datë 10.11.2017.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ: Bordi i Akreditimit dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, vendosën: Prof. As. Arlinda Ymeraj dhe Prof. Raimonda Duka, si eksperte të jashtme vlerësimi për këtë program studimi. Gjatë gjithë procedurës ekspertët e vlerësimit të jashtëm janë asistuar nga Kordinatorja Teknike e ASCAL, Znj. Emisa Isufaj.

Universiteti i New York-ut në Tiranë, është njohur me Draft – Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 30.08.2019, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 35/56 Prot., datë 03.09.2019. Universiteti i New York-ut në Tiranë përcjell në ASCAL nëpërmjet shkresës me Nr. 287/2019 Prot., datë 10.09.2019 komentet në lidhje me Draft – Raportin e Vlerësimit të Jashtëm. Ekspertët e Vlerësimit u njohën me komentet dhe vendosën të japin argumentat e mëposhtme dhe të bëjnë një reflektim si më poshtë:

Memo:

Për komentin në lidhje me rekomandimin "2. Për të përmbushur kërkesat e ligjit Nr. 80/2015 të përcaktoj titullarë modulesh personel akademik të kategorisë "Profesor". GVJ pasi shqyrtoi me kujdes objeksionin e GVB konkludoi që në raport është evidentuar që UNYT ka përmbushur dispozitat ligjore për të gjithë periudhën e akreditimit, por në të ardhmen duhet të përmbush kërkesat e ligjit Nr. 80/2015, nenit 59, pika 3 që thotë: "Në kategorinë "Profesorë" përfshihen anëtarët e personelit akademik, **titullarë të lëndëve** ose moduleve dhe udhëheqës të veprimtarisë kërkimore-shkencore. GVJ konkludoi që rekomandimi duhet të qëndrojë në raport i pandryshuar.

Për komentin në lidhje me rekomandimin "që institucioni duhet të hartojë tregues të vlerësimit periodik për të "matur" kontributin e stafit akademik në zhvillimin e kërkimit shkencor." GVJ shqyrtoi me kujdes objeksionin e GVB dhe konkludoi që politikat ekzistuese dhe praktikat e mira janë evidentuar në raport. GVB mendon që politika "A System for Approximate Measurement of the Quality / Quantity of Research Output Applied by the Faculty of Economics and Business" miratuar me vendim nr. 45, dt. 30.03.2018 të Senatit mbi vlerësimin periodik të kontributit shkencor të stafit akademik në një vit akademik, ka nevojë të ripunohet për të adresuar rekomandimin e mësipërm. Për sa më sipër GVJ i konkludoi që ky rekomandim duhet të mbetet në raport i pandryshuar.



ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKKREDITIMIN E PARË

I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit

Në bazë të procesit të fundit të akreditimit të programit Msc në Administrim Biznes në vitin 2013, paraqiten më poshtë rekomandimet e Këshillit të Akreditimit.

- a) Të rritet koha që studentët i dedikojnë kërkimit, zhvillimit personal dhe profesional.
- b) Të ulet ngarkesa mësimore e stafit efektiv meqë është relativisht e lartë.

II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

- a) Për rekomandimin "*Të rritet koha që studentët i dedikojnë kërkimit, zhvillimit personal dhe profesional*", institucioni ka bërë ndryshime në komponentët e planit mësimor duke alokuar për punën kërkimore dhe projektet në të gjitha profilet rreth 25% të krediteve. Përveç 13 moduleve themelore dhe të specialitetit në program janë dy kurse që lidhen me punimin e tezës (hartimin e pyetjeve kërkimore, të shkruarit dhe prezantimin). Për tezën/projektin janë 30 ECTS me rreth 20 orë në auditor dhe 720 orë të dedikuara për punë të pavarur dhe praktikën e studentit. **Rekomandimi është përmbushur plotësisht. [Evidencë 1]**
- b) Për rekomandimin "*Të ulet ngarkesa mësimore e stafit efektiv meqë është relativisht e lartë*" institucioni ka rekrutuar personel akademik efektiv në të gjitha Njësitë Bazë në periudhën midis dy akreditimeve dhe për rrjedhojë është rritur numri i PAE që jep mësim në këtë program studimi. Megjithatë në personelin akademik të programit ka staf me mbi 400 orë në vit dhe që japin nga 4 module. **Rekomandimi është përmbushur pjesërisht. [Evidencë 1]**

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Programi i studimit Msc në Administrim Biznesi me gjashtë profile (Profil i Përgjithshëm, Menaxhim, Menaxhim i Burimeve Njerëzore, Marketing, Menxhim i Sistemeve të Informacionit dhe Bankë) synon të aftësojë dhe formojë profesionistë me njohuri të biznesit dhe kërkues që do të jenë lider në departamentet e tyre përkatëse në industri ose në fushën akademike. Programi synon gjithashtu të aftësojë studentët për të eksploruar prirjet globale dhe zgjidhjen e problemeve të biznesit, dhënien e rekomandimeve për politikëbërësit, që do të mundësonin zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit.

Hartimi dhe përditësimi i programit të studimit është mbështetur nga strategjitë afatgjata të zhvillimit të institucionit . GVJ gjatë vizitës në institucion konstatoi që IAL ka ndërmarrë hapa për të vënë në jetë objektivat e përcaktuara në strategji si: hartimi i kurrikulave të reja, adoptimi i modeleve të reja të rekomanduara nga institucione akademike partnere, fillimi i procedurave për diplomat e dyfishta, etj. [Aneks 5]

Referuar RVB dhe informacionit të marrë gjatë takimit me drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Njesisë Bazë u informuam që ky PS është hartuar për t'i pajisur studentët me njohuri të avancuara në tematika specifike në fushën e biznesit dhe për të përmirësuar shprehitë e tyre praktike për zgjidhjen e problemeve. PS i'u mundëson gjithashtu studentëve që të thellojnë njohuritë e tyre teorike dhe të zhvillojnë prirjet kërkimore, në mënyrë që të ndjekin studimet në ciklin e tretë.

Për të arritur synimet institucioni ka përcaktuar objektiva të qarta të programit të studimit, të cilat në mënyrë të përmbledhur janë si më poshtë:

- Pajisja e studentëve me njohuri bashkëkohore në zgjidhjen e problemeve të biznesit.
- Njohja e studentëve me praktikat e të bërit biznes.
- Pajisja e studentëve me aftësitë e nevojshme për të kryer punë të pavarur kërkimore.
- Përfshirja e studentëve në rastet konkrete studimore.

Programi Msc në Administrim Biznesi në këtë format është ofruar për herë të parë në vitin 2011. PS ofrohet nga Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit dhe përgjegjës për të është Departamenti i Administrim Biznesit, i cili c ofron këtë program në bashkëpunim me Njesisë e tjera Bazë të Fakultetit.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;	PS synon synon të aftësojë dhe formojë profesionistë me njohuri të biznesit dhe kërkues që do të jenë lider në departamentet e tyre përkatëse në industri ose në fushën akademike. Nga vizita në institucion, takimi me drejtuesit dhe përsonein akademik mund të themi që PS është hartuar në përputhje me misionin e institucionit për të përgatitur drejtues të të ardhmes. Gjatë hartimit të
Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;	
Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;	
Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin	

<p>e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.</p>	<p>PS janë mbajtur në konsideratë nevojat e tregut të punës për këto profile. [RVB; Aneks 1, neni 3; Aneks 5]</p> <p>Për hartimin e PS Drejtuesit e programit kanë zhvilluar takime me Menaxher të Lartë të bizneseve të ndryshme në treg për të përfutur informacionet e nevojshme për dizenjimin e tij. Analiza është udhëhequr nga parimi që PS duhet të përputhet me zhvillimin ekonomik të vendit dhe të mbrojë interesat kombëtare. [Aneks 4.1]</p> <p>PS Msc Administrim Biznes me profile është hartuar duke mbajtur parasysh nevojat që kërkon zhvillimi ekonomik i vendit për specialistë të fushave të ndryshme të menaxhimit. Ndërsa në statut theksohet vlerësimi i trashëgimisë dhe kulturës shqiptare gjatë gjithë programeve të studimit përmes përdorimit të rasteve studimore, të dhënave dhe krahasimeve. [Aneks 1]</p>
<p>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p>	<p>PS është në përputhje me misionin dhe strategjinë për zhvillimin e institucionit. Duke iu referuar planeve strategjike të IAL (2012-2017; 2018-2022) dhe takimeve në institucion GVJ konstatoi që hartimi dhe përditësimi i PS mbështetet në strategjinë për zhvillimin e institucionit. [Aneks 5].</p>
<p>Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	
<p>Kriteri 1 Përmbajtja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>	<p>GVJ mendon që përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Programi është ndërtuar gjithashtu në përputhje me aktet rregullatore të IAL si statuti dhe rregullorja. [Aneks 1]</p> <p>Emërtimi i programit të studimit Msc në Administrim Biznes me profile është në përputhje me orientimet e Kornizës Shqiptare të Kualifikimit sipas niveli 7 të kësaj kornize.</p>
<p>Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	<p>Zhvillimi i vazhdueshëm i kurrikulave është një nga objektivat e planit strategjik 2018-2022, të cilin IAL synon ta arrijë përmes vlerësimit të vazhdueshëm të programeve ekzistuese; hartimit të programeve të reja, realizimit të ndryshimeve të nevojshme në programet ekzistuese, trajnimit dhe azhormimit të kurrikulave me rezultatet me të fundit shkencore dhe pedagogjike. [Aneks 5, fq.9]</p> <p>Gjithashtu në të njëjtin plan është përcaktuar si objektivi dhe përdorimi i metodave inovative të larmishme në mësimdhënie, mësimnxënie dhe hulumtim. UNYT angazhohet për standarde të larta teorike, empirike dhe praktike në mësimdhënies.</p>

Personeli akademik zbaton metoda të ndryshme për të kontrolluar shkallën në të cilën studentët asimilojnë materialet e kursit. [Aneks 5, fq.3]

Konkluzionet e vlerësimit:

Mbështetur në vlerësimin e dhënë për secilin nga standardet e mësipërme GVJ konkludon:

1. PS Msc në Administrim Biznes me profile është në përputhje me misionin dhe qëllimin e IAL, si dhe me strategjinë për zhvillimin e institucionit.
2. Programi i studimit ofrohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.
3. Zhvillimi dhe përmirësimi i planeve dhe i rezultateve të mësimdhënies dhe të mësimnxënies janë objektiva të përfshira në planin strategjik të institucionit 2018-2022.

2. Struktura akademike e Fakultetit (departamentit përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Terma reference: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Struktura organizative e universitetit është përcaktuar në Statutin e Institucionit dhe respekton kërkesat e Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Universiteti përbëhet nga Njësitë Kryesore, Njësitë Bazë dhe Strukturat Administrative. Universiteti i New York përbëhet nga 3 Njësi kryesore: Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit, Fakulteti i Informatikës, Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale. Programi i studimit ofrohet nga Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit, i cili përbëhet nga 3 Njësi bazë: dy departamente (Departamenti i Ekonomisë dhe Financës, Departamenti i Administrim Biznesit) dhe një qendër kërkimore (Qendra Kërkimore për Ekonominë dhe Biznesin). [RVB, Aneks 1, neni 9; Urdhër MASR nr. 288, datë 22.05.2017, Organograma] Përgjegjës për programin e studimit është Departamenti i Administrim Biznesit.

Mësimdhënia dhe veprimtaria shkencore e njësisë asistohet nga stafi ndihmës akademik dhe stafi administrativ. Fakulteti mbështet në veprimtarinë e tij nga disa struktura të cilat funksionojnë në nivel universiteti si: Zyra e Pranimeve, Zyra e Asistencës Teknologjike, Zyra e Projekteve dhe Inovacionit, Zyra e Burimeve Njerëzore, Sekretaria Mësimore, Biblioteka, etj. Detyrat dhe funksionet e tyre janë përcaktuara në statutin e universitetit. [Aneks 1, nenin 44]

Për vitin akademik 2018-2019 Fakulteti ka në përbërjen e tij 49 personel nga të cilët 21 personel akademik efektiv, 5 personel akademik me kontratë dhe 23 personel administrativ. Numri i personelit akademik efektiv ka qënë i njëjtë për 3 vitet e fundit akademike dhe i shpërndarë në mënyrë të barabartë ndërmjet njësive bazë (7 antarët për secilën njësi). Ndërsa numri i personelit akademik me kontratë dhe personelit administrativ ka patur ndryshime të vogla. [Aneks Tabela 1]

Personeli akademik efektiv përbëhet nga 1 Profesor, 3 Profesor të Asociuar, 8 Phd, 1 Phd në proces dhe 8 Msc për vitin akademik 2018-2019. Ndërsa i gjithë personeli akademik me kontratë ka gradën Phd. Kërkesat e ligjit për përbërjen e personelit akademik në nivel njësie bazë janë respektuar për të gjithë periudhën ndërmjet dy akreditimeve.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Struktura akademike e Fakultetit

Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit përbëhet nga 3 Njësi bazë: Departamenti i Administrim Biznesit, Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës dhe Qendra Kërkimore për Ekonominë dhe Biznesin. Fakulteti drejtohet nga Dekani, ndërsa çdo departament dhe qendra kërkimore drejtohen nga Drejtuesit e Departamentit dhe Drejtuesi i Qendrës. Funkcionet e drejtuesve dhe organeve kolegjiale janë të përcaktuara në statutin e IAL. Dekanati është organ kolegjial që drejtohet nga dekani, që harton planin strategjik të zhvillimit të njësisë kryesore dhe koordinon veprimtarinë e njësisë bazë. Dekani i Fakultetit është autoriteti më i lartë akademik i njësisë kryesore dhe përfaqësues i saj. Dekani koordinon veprimtarinë e njësisë bazë dhe organeve kolegjiale të njësisë kryesore dhe zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet tyre. Drejtuesit e Njësive bazë drejtojnë aktivitetet e njësisë dhe marrin pjesë në Dekanat. Ata kanë përgjegjësi për përpilimin dhe promovimin e drejtimit strategjik të departamentit, menaxhimin dhe detyrat akademike e administrative të departamentit, përgatitjen e programeve të lëndëve dhe shpërndarjen e ngarkesës mësimore të pedagogëve të departamentit; mbikëqyrin aktivitete të kërkimit dhe të mësimdhënies, si edhe aktivitete të tjera ndëruniversitare duke siguruar arritjen e objektivave dhe cilësisë, etj. [Aneks 1, nenet18, 20, 24].

- Të dhëna për Stafin akademik të Departamentit përgjegjës

Departamenti përgjegjës për programin e studimit është: Departamenti i Administrim Biznesit. Sipas RVB dhe vizitës në IAL realizimi i planit mësimor për këtë program studimit mundësohet gjithashtu në bashkëpunim me Departamentin e Ekonomiksit dhe Financës dhe Qendrën Kërkimore për Ekonominë dhe Biznesin. Për vitin akademik 2018-2019 stafi i i secilës nga Njësitë bazë është si më poshtë:

Departamenti Menaxhim Biznesit përbëhet nga 7 (shtatë) personel akademik efektiv dhe 2 (dy) personel akademik me kontratë. Njësia bazë, Departamenti drejtohet në të gjithë veprimtarinë e tij nga përgjegjësi i departamentit, që ka gradën Doktor. Stafin akademik i departamentit ka 1 (një) antar me titullin Prof.As, 3 (tre) anëtar që kanë gradën Doktor, dhe 3 (tre) anëtar me kualifikimin Msc. [RVB fq. 11, Tabela 1.1].

Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës përbëhet nga 7 (shtatë) personel akademik efektiv (PAE), 3 (tre) personel akademik me kontratë (PAK). Njësia bazë, Departamenti drejtohet në të gjithë veprimtarinë e tij nga përgjegjësi i departamentit, që mban titullin Prof. Dr. Stafin akademik i departamentit ka 1(një) anëtar që mban titullin Profesor, 2 (dy) Prof.Asociuar, 2 (dy) antarë që mbajnë gradën Phd dhe 2 (dy) anëtar me kualifikimin Msc. [RVB, fq. 11, Tabela 1.1].

Qendra Kërkimore për Ekonominë dhe Biznesin përbëhet nga 7 (shtatë) personel akademik efektiv (PAE). Njësia bazë, Qendra drejtohet në të gjithë veprimtarinë e tij nga shefi i qendrës, që mban gradën Phd. Stafin

akademik i qendrës ka 3 (tre) antarë që mbajnë gradën PhD dhe 4 (katër) anëtar me kualifikimin Msc. [RVB fq. 11, Tabela 1.1].

Për periudhën midis dy akreditimeve raportet PAE/PAK të departamentit të Menaxhim Biznesit kanë qënë si më poshtë: [RVB, Tabela 2]

Për vitin akademik 2018-2019, (7 / 2), nga këta me grada/tituj 4 / 2;

Për vitin akademik 2017-2018, (7 / 5), nga këta me grada/tituj 3 / 4;

Për vitin akademik 2016-2017, (7 / 3) nga këta me grada /tituj 4 / 1;

Për vitin akademik 2015-2016, (7 / 3) nga këta me grada /tituj 4 / 0;

Për vitin akademik 2014-2015, (8 / 6) nga këta me grada /tituj 6 / 2;

Për vitin akademik 2013-2014, (7 / 12) nga këta me grada /tituj 2 / 4.

Për periudhën midis dy akreditimeve raportet PAE/PAK të departamentit të Ekonomiksit dhe Financës kanë qënë si më poshtë: [RVB, Tabela 2]

Për vitin akademik 2018-2019, (7 / 3), nga këta me grada/tituj 5 / 3;

Për vitin akademik 2017-2018, (7 / 7), nga këta me grada/tituj 5 / 3;

Për vitin akademik 2016-2017, (7 / 2) nga këta me grada /tituj 5 / 1;

Për vitin akademik 2015-2016, (7 / 10) nga këta me grada /tituj 5 / 5;

Për vitin akademik 2014-2015, (11 / 6) nga këta me grada /tituj 8 / 3;

Për vitin akademik 2013-2014, (5 / 9) nga këta me grada /tituj 3 / 3.

Për periudhën midis dy akreditimeve raportet PAE/PAK të Qendrës Kërkimore për Ekonominë dhe Biznesin kanë qënë si më poshtë: [RVB, tabela 2]

Për vitin akademik 2018-2019, (7 / 0), nga këta me grada/tituj 3 / 0;

Për vitin akademik 2017-2018, (7 / 0), nga këta me grada/tituj 3 / 0;

Për vitin akademik 2016-2017, (7 / 0) nga këta me grada /tituj 4 / 0;

Për vitin akademik 2015-2016, (5 / 2) nga këta me grada /tituj 3 / 1;

Për vitin akademik 2014-2015, (6 / 0) nga këta me grada /tituj 4 / 0;

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Gjatë vizitës në institucion nuk kërkua dokumentacion shtesë.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.	
Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;	GVJ është i mendimit që struktura organike e UNYT mbështet plotësisht përmbushjen e misionit dhe vizionit të këtij institucioni. Përveç Njësive Kryesore dhe Njësive Bazë universiteti ka dhe shumë struktura ndihmës akademike dhe administrative që i shërbejnë arritjes së objektivave. Sipas dokumentacionit dhe vizitës në UNYT, GVJ konstatoi që IAL përbëhet nga 3 Njësi kryesore dhe
Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete;	
Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;	

<p>Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;</p> <p>Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore “Doktor”.</p>	<p>secila prej tyre ka tre Njësi Bazë, nga të cilat dy janë departamente dhe një qendër, misioni dhe objektivat e të cilave janë të përcaktuara në statut dhe rregulloret e PS. [Aneks 1, neni 9, Aneks 9]</p> <p>Të gjitha Njësitë Bazë të Fakultetit të Ekonomisë kanë aktualisht në përbërjen e tyre 3 dhe më shumë personel akademik me gradën shkencore “Doktor”. [RVB fq. 11, Tabela 1.1] Ky kriter është plotësuar për të gjithë periudhën 2014-2019 nga të dy departamentet dhe për tre vitet e fundit akademike dhe për Qendrën Kërkimore.</p>
<p>Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p>	<p>Strukturat e Njësisë Kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësinë që ato kanë për realizimin e PS. Ky opinion u krijua mbështetur në takimet e zhvillura me drejtuesin e Njësisë kryesore, Drejtuesit e Njësisë Bazë dhe personelin akademik.</p> <p>Referuar RVB, dokumentacionit dhe vizitave në institucion GVJ konkludoi që Njësia Bazë dhe Njësia Kryesore janë të përfshira dhe kanë rol kryesor në procesin e rekrutimit të personelit. Vendet vakante identifikohen nga Departamenti, i cili propozon kriteret që duhet të plotësohen. Kriteret miratohen nga Dekani dhe për rekrutimin ngrihet një komision <i>ad hoc</i>.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <p>Mbështetur në vlerësimin e dhënë për secilin nga standardet e mësipërme GVJ konkludon:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. UNYT është organizuar në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, duke krijuar strukturat akademike, ndihmës-akademike dhe ato administrative. Organograma e tij është në funksion të përmbushjes së misionit. 2. Drejtuesit e të gjitha niveleve dhe personeli akademik janë të angazhuar dhe të përkushtuar për realizimin e PS. 	

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Personeli akademik i programit të studimit Msc në "Administrim Biznesi" me profile përbëhet nga 11 (njëmbëshjetë) pedagogë për vitin akademik 2018-2019, ndër të cilët 8 (tetë) janë Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe 3 (tre) Personel Akademik me Kontratë (PAK). Raporti PAE/PAK për këtë vit akademik është 8 / 3. Numri i personelit akademik me tituj dhe grada është 10 (dhjetë) ose 90.1% e personelit të përgjithshëm. Nga këta 7 (shtatë) ose 70.0% janë Personel Akademik Efektiv (PAE). Numri i personelit ndihmës akademik është 23 (njëzetë e tre) dhe është për të gjithë Njësinë Kryesore. Raporti PAE/PA për vitin aktual akademik për këtë program studimit është 8 / 23 ose 1 / 2.9. ***Në periudhën 2015-2019 në programin e studimit është përfshirë dhe personeli me kualifikimin Msc. Në vitin akademik 2017-2018 janë 6 nga 16; në vitin akademik 2016-2017 janë 5 nga 16; në vitin akademik 2015-2015 janë 4 nga 14.*** [RVB, Tabela 4, fq. 24]

Mbështur në dokumentacionin e dorëzuar në ASCAL dhe takimin e zhvilluar në institucion me personelin, GVJ konkludoi që UNYT ka një personel akademik dhe ndihmës akademik të kualifikuar, me eksperiencë në fushën e mësimdhënies dhe i motivuar për realizimin e programit mësimor. Ngarkesa e punës e personelit akademik është rregulluar me kontratë, duke mbajtur në konsideratë veprimtarinë mësimdhënëse në auditor, veprimtari jashtë auditorit dhe në mbështetje të procesit mësimor, dhe kontributi institucional. **[Aneks 2.1]**

Institucioni i vuri në dispozicion GVJ shpërndarjen e ngarkesës mësimore për tre vitet e fundit akademike (2016-2019) për të gjitha ciklet. Ngarkesa mesatare në auditor për personelin akademik të Departamentit të Administrim Biznesi është 297 orë mësimore në vit. Megjithatë u konstatua që në ndonjë rast personeli akademik përballonte një ngarkesë në auditor më të madhe se 400 orë në vit. Drejtuesit e Njësisë Kryesore gjatë takimit na informuan që për të ulur ngarkesën e personelit akademik në auditor është menduar që të bashkohen klasat që kanë module të njëjta. Ndërsa ngarkesa javore për PAE luhet nga 9+12 orë në javë, në 2 deri në 4 kurse. **[RVB, fq.24, Evidencë 9+23, vizita në insitucion]**

Rekrutimi i personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ bëhet sipas procedurave të përcaktuara në statutin dhe rregulloren e institucionit, të cilat mbajnë në konsideratë aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. **[Aneksi 1, kapitulli III]** Vendet vakante të identifikuara nga departamenti dhe të miratuara nga Bordi i Administrimit, publikohen në median e shkruar dhe elektronike, së bashku me përshkrimin e punës për pozicionin respektin. Kriteret e punësimit dhe kualifikimet e kërkuara për personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesëshme përcaktohen nga njësia bazë, miratohen nga Dekani dhe u përcillen për dijeni autoriteteve të universitetit. Ndër kriteret kryesore që vendosen janë: institucioni ku kandidati ka kryer studimet në të gjitha ciklet, gradat dhe titujt akademikë, veprimtaria kërkimore, eksperiencia në mësimdhënie dhe letrat e rekomandimit.

Për rekrutimin e personelit akademik ngrihet Komisioni *ad hoc*, i cili shqyrton aplikimet, dokumentacionin e dorëzuar nga aplikantët dhe del me një listë të shkurtër. Kandidatët që përzgjidhen thirren për intervistë dhe ka raste që i'u kërkohet të mbajnë një leksion të shkurtër. Gjatë vizitës në institucion dhe nga RVB, GVJ konstatoi që institucioni mban dokumentacion të plotë për rekrutimin e stafit, vendet e lira, njoftimet mbi vendet e lira të punës, etj. Pas përfundimit të procesit të rekrutimit i gjithë dokumentacioni ruhet në Zyrën e Burimeve Njerëzore.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat, (Plotëso Tabelat në Aneks, të cilat mund të plotësohen edhe nga verifikimi i tabelave të paqyruara në RVB)

Të dhënat për Personelin Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelin Akademik me Kontratë (PAK), që janë përfshirë në programin e studimit Msc Administrim Biznes me profile paraqiten në tabelën 4 [shih në Aneks]. Gjatë vizitës në institucion u konfirmua që të dhënat e paraqitura në këtë tabelë përputhen me gjendjen në institucion. Nga analiza e të dhënave për personelin akademik të përfshirë në mësimdhënien e programit të studimit për periudhën 2013-2019, rezulton si më poshtë: [RVB, Tabela 4]

- ✓ Për vitin akademik 2018-2019, personeli akademik përbëhet nga 11 pedagogë, nga të cilët 8 PAE dhe 3 PAK (ose 72.7%/27.3%).
- ✓ Për vitin akademik 2017-2018, personeli akademik përbëhet nga 16 pedagogë, nga të cilët 13 PAE dhe 3 PAK (ose 81.3%/18.7%).
- ✓ Për vitin akademik 2016-2017, personeli akademik përbëhet nga 16 pedagogë, nga të cilët 9 PAE dhe 7 PAK (ose 56.3%/43.7%).
- ✓ Për vitin akademik 2015-2016, personeli akademik përbëhet nga 14 pedagogë, nga të cilët 10 PAE dhe 4 PAK (ose 71.4%/28.6%).
- ✓ Për vitin akademik 2014-2015, personeli akademik përbëhet nga 16 pedagogë, nga të cilët 9 PAE dhe 7 PAK (ose 56.3%/43.7%).
- ✓ Për vitin akademik 2013-2014, personeli akademik përbëhet nga 16 pedagogë, nga të cilët 8 PAE dhe 8 PAK (ose 50.0%/50.0%).

Numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi në tre vitet e fundit (2016-2019) është 60 studentë. Sipas llogaritjeve të bëra raporti Personel Akademik Efektiv/ student në këtë program studimi për vitin akademik aktual është 8 / 60 ose 1 / 7.5.

Raporti PAE/PAK në këtë program për vitin akademik aktual është 8 / 3 ose 2.6/1.

Mbështetur në analizën e të dhënave të mësipërme, GVJ konstaton se në periudhën midis dy akreditimeve Personeli Akademik Efektiv ka qënë mbi normën 70.0% për tre vite akademike dhe nën këtë normë për tre vitet e tjera. Në dy vitet e fundit akademike 2018-2019 dhe 2017-2018 shifrat kanë qënë respektivisht 81.3% dhe 72.7%.

- Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinator/ët e programit të studimit

Të dhënat për Këshillin Shkencor të Programit të studimit Msc në Administrim Biznes me profile, paraqiten në tabelën 3. [RVB, Tabela 3, fq.17] Referuar kësaj table, Këshilli Shkencor përbëhet nga 3 personel akademik efektiv, ku shefi i përket kategorisë "Profesor" dhe dy antarët e tjerë kanë gradën "Doktor".

Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre

Tabela 3 në aneks paraqet të dhënat sipas kualifikimit dhe raportet midis tyre për personelin akademik që është përfshirë në këtë program studimi. Nga të dhënat e tabelave rezultojnë:

- ✓ Viti akademik 2018-2019 10 (dhjetë) personel me tituj dhe grada ose 90.9% e numrit të përgjithshëm, nga të cilët 3 (tre) PAK (10/3).
- ✓ Viti akademik 2017-2018 10 (dhjetë) personel me tituj dhe grada ose 62.5% e numrit të përgjithshëm, nga të cilët vetëm 2 (dy) PAK (10/2).
- ✓ Viti akademik 2016-2017 10 (dhjetë) personel me tituj dhe grada ose 62.5% e numrit të përgjithshëm, nga të cilët vetëm 4 (katër) PAK, (10/4).
- ✓ Viti akademik 2015-2016 9 (nëntë) personel me tituj dhe grada ose 64.3% e numrit të përgjithshëm, nga të cilët 1 (një) PAK (9/1)
- ✓ Viti akademik 2014-2015 14 (katërmëdhjetë) personel me tituj dhe grada ose 87.5% e numrit të përgjithshëm, nga të cilët 5 (pesë) PAK, (14/5).
- ✓ Viti akademik 2013-2014 10 (dhjetë) personel me tituj dhe grada ose 62.5% e numrit të përgjithshëm, nga të cilët 2 (dy) PAK, (10/2).

Mbështetur në analizën e të dhënave të mësipërme, GVJ konstaton që UNYT për të gjithë periudhën midis dy akreditimeve është kujdesur që të harmonizojë më së miri PAE me tituj dhe grada me PAK në funksion të realizimit të programit mësimor.

Të dhënat sipas seksit

Duke analizuar përbërjen e stafit akademik të Fakultetit të Ekonomisë sipas gjinisë, GVJ konstatoi që raportet gjinore kanë ndryshuar në vite për të gjithë periudhën 2013-2018 në favor të gjinisë femërore. Përjashtim bëjnë vitet akademike 2013-2014 dhe 2014-2015, në të cilin raportet gjinore janë të balancuara (58.3% dhe 56.0% janë femra), ndërsa në vitet akademike pasardhëse këto raporte kanë ndryshuar në favor të femrave. Përqindjen më të lartë femrat e zënë në vitin akademik 2018-2019 me 71.4%. Për periudhën 2013-2019 personeli akademik femra ka qënë mesatarisht në masën 63.8%.

Gjithashtu personeli akademik efektiv i departamente përbëhet kryesisht nga femra. Për periudhën 2013-2019, GVJ konstaton që të dhënat sipas gjinisë në departamente është si më poshtë:

- ✓ Departamenti i Administrim Biznesit - për vitin akademik 2018-2019 raporti femra/meshkuj në këtë departament është 4 / 3. Për të gjithë periudhën 2013-2019 mesatarisht 53.4% e personelit akademik kanë qënë femra.
- ✓ Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës - për vitin akademik 2018-2019 raporti femra/meshkuj në këtë departament është 6 / 1. Për të gjithë periudhën 2013-2019 mesatarisht 74.9% e personelit akademik kanë qënë femra.

- ✓ Qendra Kërkimore për Ekonominë dhe Biznesin - për vitin akademik 2018–2019 raporti femra/meshkuj në qendër është 5 / 2. Për të gjithë periudhën 2014-2019 mesatarisht 62.5% e personelit akademik kanë qenë femra.

- ☑ Të dhëna sipas moshës së personelit

Tabela 6 në aneks paraqet përbërjen sipas moshës të PAE dhe PAK të programit të studimit. Të dhënat janë për të gjithë periudhën 2013-2019. Bazuar në këto të dhëna, GVJ konstaton që UNYT për të gjithë periudhën midis dy akreditimeve ka harmonizuar shpërndarjen mes grup moshave për PAE dhe PAK. Kështu mesatarisht për të gjithë periudhën 47.4% e PAE i përkasin grup moshës 25-35 vjeç, 26.0% e PAE i përkasin grup moshës 36-45 vjeç dhe 11.2% grup moshës 46-55 vjeç. Ndërsa për PAK 33.7% e PAE i përkasin grup moshës 25-35 vjeç, 32.7% e PAE i përkasin grup moshës 36-45 vjeç dhe 15.0% grup moshës 46-55 vjeç. Të dhënat sipas moshës për PAE paraqiten me ndryshime shumë të vogla për katër vitet e fundit akademike. Për periudhën 2013-2018 rreth 50% e PAK i takojnë grup moshës 36-45 dhe 46-55 vjeç. Pesha më e madhe e këtyre grup moshave lidhet me rekrutimin e PAK me kualifikime të larta ose ekspertë të fushës.

- ☑ Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Për realizimin e programit të studimit UNYT punëson personel akademik me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme. [Aneks 1, neni 37-40] GVJ mbështetur në RVB, dokumentacionin mbështetës të dorëzuar në ASCAL dhe informacionin e marr gjatë takimeve me personelin në institucion konkludoi që personeli akademik gëzon status dhe trajtim të veçantë sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, të cilat rregullohen përmes kontratës së punës. UNYT përdor dy kontrata tip për personelin akademik: kontrata për PAE dhe kontrata për PAK. Kontrata e punës përcakton objektin dhe termat e kontratës, modulën, shpërndarjen e ngarkesës, detyrimet e punëdhënësit dhe punëmarrësit. Kontratat e punës për PAE janë paafat. Ndërsa kontratat për PAK janë kontrata shërbimi dhe lidhen për një vit akademik/ose semestër. Aneksi i kontratës ka të detajuar ngarkesën e punës sipas të gjitha rubrikave. Sipas statutit kontrata firmoset nga Rektori në emër të punëdhënësit. Gjatë vizitës në institucion u konstatua që personeli akademik i njëjtte detyrat dhe të drejtat dhe se kishte firmosur kontratën e punës me punëdhënësin. [Aneks 1, neni 38]

- ☑ Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

Personeli ndihmës mësimor dhe personeli administrativ kryejnë veprimtari ndihmëse në mësimdhënie, në ofrimin e shërbimeve dhe proceseve administrative në përputhje me misionin dhe programet akademike të UNYT. Procedurat e rekrutimit, punësimit dhe ato të vlerësimit të punës janë të përcaktuara në statutin dhe rregulloren e institucionit. Gjatë vizitës në institucion GVJ mori takim me një pjesë të stafit ndihmës (Zyra e projekteve dhe inovacioni, Zyra e Burimeve Njerëzore, Zyrën e karrierës dhe Marrëdhëniet me të Diplomuarit, Sekretaria mësimore dhe Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë) dhe konstatoi që institucioni ka personel ndihmës mësimor dhe personel administrativ të kualifikuar dhe që mbështet realizimin e programit të studimit.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion
Gjatë vizitës në institucion nuk kërkuan dokumentacion shtesë.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësues-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësues-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësues-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	<p>Mbështetur në RVB dhe në takimet e zhvilluara me personelin e UNYT, GVJ konstatoi që personeli akademik, ndihmës-akademik dhe administrativ angazhohet për arritjen e objektivave të programit të studimit. Përveç procesit të mësimit ata angazhohen dhe në veprimtari mbështetëse dhe administrative. [Aneks 2.3]</p> <p>Ata janë angazhuar gjithashtu në përputhje me strategjinë për zhvillimin e institucionit. [Aneks 5]</p>
Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>	<p>Sipas RVB dhe nga takimet me drejtuesit e Njësive Kryesore, Njësive Bazë dhe personelin akademik rezultoi që të gjithë titullarët e lëndëve përfshihen në rishikimin e syllabuseve dhe ndryshimet në planin mësimor, të cilat i kalojnë për miratim Senatit Akademik. Për rishikimin e kurrikulës janë marrë gjithashtu në konsideratë dhe reagimet e profesionistëve dhe komunitetit të biznesit.</p> <p>Rekrutimi i personelit akademik dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Ngarkesa mësimore është pjesë e kontratës me punëdhënësin.</p>
Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të</p>	<p>Bazuar në RVB dhe dokumentacionin shoqëruar, GVJ konstatoi që IAL ka procedura të mirëpërcaktuara për rekrutimin e personelit. Në takimet me personelin u theksua që procedurat janë transparente dhe rekrutimi i tyre është realizuar në përputhje me këto procedura [Aneksi 1, Aneksi 7.1]</p> <p>IAL ka angazhuar PAE dhe PAK për realizimin e PS. Treguesi mbi 70.0% është arritur vetëm për 3 nga 6 vitet akademike që përfshin periudha e akreditimit. Për vitin akademik 2018-2019, PAE përbën 72.7% të personelit të angazhuar për këtë program studimi. Numri i PAK ka ndryshuar gjatë gjithë periudhës. Numri më i vogël është në vitin akademik 2015-2016.</p> <p>IAL realizon në mënyrë periodike vlerësimin e personelit, përmes formularit të vlerësimit të performancës individuale. Instrumenti është pjesë e</p>

<p>raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.</p>	<p>manualit për sigurimin e cilësisë dhe siguron vlerësim shumëdimensional: mësimdhënia, kërkimi, shërbimet për komunitetin dhe vetëzhvillimi [Aneks 24]. Vlerësimi i personelit bëhet gjithashtu nga kolegët dhe studentet. Ky vlerësim ka për qëllim nxitjen e diskutimeve për mësimdhënien, mësimnxënien dhe përmirësimin e tyre në të ardhmen. [Aneks 23 dhe 25]. Gjatë takimit GVJ konstatoi që personeli i njihte procedurat e vlerësimit, kishte marr pjesë në proces dhe ishte në dijeni të rezultateve të vlerësimit. Procedura e rekrutimit dokumentohet në të gjitha fazat dhe pas përfundimit të procesit depozitohet në Zyrën e Burimeve Njerëzore. [Aneks 7.1]</p>
<p>Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.</p>	
<p>Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve përëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;</p> <p>Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p> <p>Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>	<p>Programi i studimit është drejtuar për të gjithë periudhën midis dy akreditimeve nga personel akademik me gradën PhD nga një Universitet Amerikan dhe me përvojë akademike.</p> <p>Sipas orarit të kurseve për periudhën 2017-2019 rezultojnë që titullarët e moduleve kanë gradën shkencore “Doktor” ndërsa për kursin 2018-2019 mungojnë në disa raste emrat e personelit që do të drejtojnë modulën [Aneks 2.4]</p> <p>Mbështetur në informacionin e marr nga institucioni dhe nga vizita në institucion GVJ konkludoi që të gjithë drejtuesit e UNYT, drejtuesit e Njësisë Kryesore, të Njësisë Bazë dhe përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë.</p> <p>Referuar vizitës në institucion, GVJ konkludoi që UNYT ka personel të mjaftueshëm për drejtimin dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale në këtë program studimi.</p>
<p>Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet</p>	<p>Çdo student i caktohet një udhëheqës për tezën e masterit, i cili e udhëheq atë për një periudhë 6-mujore. Studentëve i'u vihen gjithashtu në dispozicion udhëzimet për tezën dhe orintohen për burimet e literaturës. [Aneks 2.5]</p> <p>Udhëheqësit caktohen nga Drejtoresha e Programit, mbështetur në kërkesat e studentëve dhe ekspertizën kërkimore të tyre. Udhëheqësit plotësojnë kushtin që të kenë gradën doktorë. Mbështetur në numrin e ulët të</p>

<p>e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p>studentëve në këtë PS, GVJ konkludon që nuk ka mundësi që të ketë mbingarkesa të personelit akademik për mbikëqyrjen e tezave të masterit. [Aneks 2.6]</p>
<p>Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.</p>	
<p>Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p>Personeli akademik me grada dhe tituj i angazhuar në këtë PS është i specializuar në fusha të ndryshme të menaxhimit. Në përgjithësi bëhen përpjekje nga drejtuesi i programit që udhëheqësit të caktohen duke marrë në konsideratë fushën ku dëshiron të punojë studenti dhe ekspertizën që ka udhëheqësi. [Aneks 2.2]</p> <p>Mbështetur në CV e personelit akademik dhe takimin në institucion, GVJ krijoi opinionin që personeli ka njohuri teorike dhe aftësi kërkimore në fushën e menaxhimit.</p>
<p>Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>UNYT përdor TI për të rritur cilësinë e mësimdhënies dhe të nxëniet në të gjitha PS. Gjatë vizitës në sallat e leksioneve dhe laboratore konstatuam që në institucion ka personel të dedikuar për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e softeve dhe pajisjeve hardware. [Aneks 28, 29 dhe 30]</p> <p>Gjatë takimit me drejtuesit dhe personelin akademik u informuam që PS mbulohet nga Departamenti i Administrim Biznesit, por ai mbështet dhe nga dy njësi të tjera: Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës, si dhe Departamenti i Shkencave Kompjuterike. Fakulteti ka caktuar gjithashtu një antarë të personelit akademik si Koordinator të Programit, i cili përgjigjet për të gjithë logjistikën dhe çështjet administrative që lidhen me programin.</p>
<p>Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>	<p>Referuar të dhënave që morëm për shpërndarjen e ngarkesës mësimore dhe planit mësimor të lidhur me personelin akademik për këtë program studimi konstatuam që personeli akademik realizon një ngarkesë mësimore në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Ngarkesa në auditor vlerësohet në orë mësimore. Gjithashtu me orë vlerësohen aktivitetet mbështetëse si drejtimi, menaxhimi dhe administrimi, si dhe aktiviteti kërkimor. Ngarkesa mësimore është aneks i kontratës së punës për personelin akademik.</p>
<p>Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</p>	

<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.</p>	<p>Mbështetur në RVB dhe në dokumentet e dorëzuara, GVJ konstatoi që IAL ka një bazë të dhënash të plotë për personelin akademik që është përfshirë në PS. Në këtë bazë të dhënash përfshihen titulli i modulit, viti dhe semestri i ofruar, orari, salla dhe numri i krediteve. [Aneksi 2.4]</p> <p>Procedurat e rekrutimit të personelit akademik rregullohen nga statuti i IAL. [Aneks 1, nenet 36÷42] Kriteret e punësimit dhe kualifikimet e kërkuara për personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme përcaktohen nga njësia bazë dhe miratohen nga Dekani. Sipas RVB dhe takimit në IAL, GVJ konstatoi që kriteret e rekrutimit publikohen në media e shkruar dhe atë elektronike. [Aneks 7.3]</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>Mbështetur në vlerësimin e dhënë për secilin nga standardet GVJ konkludon:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Kriteret dhe procedurat e rekrutimit dhe vlerësimit bazohen në legjislacionin në fuqi, ato janë të hapura dhe transparente. Personeli akademik ka kualifikimin e nevojshëm dhe aktualisht 72.7% e personelit akademik të angazhuar për realizimin e PS është PAE. Institucioni disponon një bazë të plotë të dhënash për personelin e tij. 2. UNYT ka angazhuar në <i>përgjithësi</i> personel akademik me tituj dhe grada për të realizuar PS. Ngarkesa mësimore e personelit mbështet në aktet ligjore e nënligjore në fuqi dhe është e përcaktuar në kontratën me punëdhënësin. 3. UNYT i mbështet studentët për realizimin e tezës së masterit. Ata kanë gjithmonë një udhëheqës, fusha kërkimore e të cilit përputhet ose është e përafërt me fushën në të cilën do të përgatitet teza. 4. Në funksion të PS ka personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ që mbështet përmbushjen e tij. 5. UNYT ka hartuar manuale dhe organizuar seminare për të mundësuar kualifikimin e mëtejshëm dhe të vazhdueshëm të personelit akademik dhe ndihmës akademik, sidomos të stafit pa eksperiencë. <p><i>Rekomandim:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Të evitohet angazhimin qoftë dhe në raste të veçanta të personelit akademik që nuk ka gradën "Doktor".</i> 2. <i>Për të përmbushur kërkesat e ligjit Nr. 80/2015 të përcaktoj titullarë modulesh personel akademik të kategorisë "Profesor".</i> 	

4. **Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit**

Pjesa përshkrimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

UNYT e zhvillon veprimtarinë e tij akademike në dy godina të reja në zonën e "Kodrës së Diellit" që prej Tetorit 2014. Infrastruktura garanton që veprimtaria e institucionit të realizohet në mënyrë të efektshme. UNYT ka në përdorim objekte reja, të ndërtuara me materiale cilësore, që plotësojnë kushtet higjeno-sanitare.

[Aneks 32] GVJ gjatë vizitës në institucion konstatoi që në këto objekte janë shmangur elementet e rrezikshmërisë duke instaluar hidrantët kundër zjarrit, sipas standardeve bashkëkohore. Objektet sigurojnë akustikë dhe izolim të mirë nga zhurmat, nga luhatjet e temperaturës dhe të lagështirës në të gjitha mjediset. Godinat ndodhen larg zonave industriale apo zonave me ndotje të ajrit mbi normat e lejuara sipas standardeve të BE-së. UNYT disponon një sipërfaqe në funksion të aktivitetit akademik, aktivitetit mbështetës dhe rekreativ prej 5331.4 m². Hapësirat në funksion të mësimdhënies janë rreth 1132.4 m², ndërsa në funksion të personelit janë 1052.8m². Siperfaqe në m² për student në këtë institucion është brenda normave. Institucioni ka burime alternative për furnizimin me energji elektrike dhe me ujë të pijshëm. Godinat kanë sistem ngrohje dhe ftohje qendror, janë të rrethuara me hapësira të gjelbërta dhe kanë një parkim të madh, i cili ofrohet pa pagesë për personelin dhe studentët. UNYT ka gjithashtu ambiente sportive që përdoren për aktivitete të ndryshme. [RVB fq.31-32]

UNYT ka një bibliotekë me sipërfaqe 215m², e cila krijon një ambient të përshtatshëm dhe komod për lexuesin. Biblioteka numëron mbi 7317 tituj librash, ndërsa ka abonim të përvitshëm në tre librari online: Jstor, Ebrary dhe Emerald. Universiteti përfiton gjithashtu akses nga bibliotekat online të Empire State Collage duke aksesuar disa baza të dhënash, si: dhe nga burimet online të Bankës Botërore. Në mjediset e bibliotekës janë instaluar 20 kompjutera, të cilat mundësojnë aksenin në të gjitha libraritë online. Në vitin 2017, UNYT ka finalizuar një marrëveshje me McGraw Hill në bazë të së cilës, studentët dhe stafi akademik kanë të drejtë të aksesojnë bibliotekën virtuale të McGraw Hill. Për vitin 2017 UNYT ka shpenzuar rreth 30,000 USD për të gjitha abonimet online. [Aneks 34]

Në mbështetje të studentëve funksionon salla e internetit, shërbimi për fotokopje, zyra e informacionit për studentët, mjedise sportive, mjedise për aktivitetet e qeverisë studentore si dhe mjedise shlodhëse (kafe, etj.)

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Mjediset për Programin e studimit (Plotëso Tabelat në Aneks, të cilat mund të plotësohen edhe nga verifikimi i tabelave të paqyruara në RVB)

Për të dhënat e infrastrukturës, GVJ është mbështetur në tabelën 7 në RVB dhe verifikimet që bëri gjatë vizitës në institucion. Të dhënat për infrastrukturën janë paraqitur në nivel të universitetit dhe jo në nivel Njësie Kryesore dhe Njësie Bazë. Referuar vizitës në institucion GVJ vlerëson që UNYT ka vendosur në funksion të programeve të studimit infrastrukturën e nevojshme, me kapacitete të mjaftueshme dhe duke respektuar normat e ndricimit, furnizimit me ujë dhe energji, sistemin e ajrimit, ngrohjes dhe ftohjes. Gjithashtu në mjediset e UNYT ka akses pa limit në internet dhe në sallat e leksioneve janë instaluar pajisjet e nevojshme didaktike (tabela, projektor, kompjutera). [Aneks Tabela 7]

- Mjediset për stafin:

UNYT ka në dispozicion të personelit akademik 8 zyra me sipërfaqe 305 m², 5 zyra me sipërfaqe 350m² janë në dispozicion të drejtuesve të departamenteve dhe qendrave kërkimore, ka zyra të vecanta për Dekanin,

Administratorin, zv.Dekanët. Në funksion të stafit janë dhe disa zyra të tjera si: zyra për sekretarinë mësimore, zyra e financës, zyra për NJSBC, sallë për mbledhje, etj. Të dhëna të detajuara për këto mjedise gjenden në tabelen 7.1 në aneks.

Referuar të dhënave të mësipërme, GVJ vlerëson UNYT ka vendosur në dispozicion personelit infrastrukturën e duhur, me kapacitete të mjaftueshme dhe me kushtet nevojshme për mbarëvajtjen e punës.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion
Gjatë vizitës në institucion nuk kërkuam dokumentacion shtesë.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p> <p>Kriteri 2 Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p> <p>Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	<p>UNYT e zhvillon aktivitetin e tij që prej vitit 2014 në dy godina të lidhura tek "Kodra e Diellit". Gjatë vizitës në institucion u informuam që institucioni do të vazhdojë veprimtarinë e tij dhe për vitin akademik pasardhës në këto mjedise.</p> <p>Mjediset mirëmbahen dhe plotësojnë të gjitha standardet për realizimin e veprimtarisë së institucionit. [Aneks 32 dhe 33]</p>
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi që IAL disponon një bibliotekë të pasur me 7317 vëllime në hardcopy dhe 50 mijë burime elektronike përmes bibliotekave online. Botimet shkencore mbulojnë të gjitha profilet e programit të studimit. [Aneks 34]</p> <p>Biblioteka ka akses në disa librari online, të mundësuar nga abonime vjetore dhe përmes bashkëpunimit me Empire State Collage. Fondi i bibliotekës përmban libra dhe revista që i shërbejnë realizimit me sukses të programit të studimit. Në vitin 2017 UNYT ka shpenzuar rreth 30 mijë dollarë për abonime në librari online dhe marrëveshjen me Mc Graw Hill. Të gjitha burimet elektronike mund të aksesohen 7/24 përmes sistemit online.</p> <p>Biblioteka funksionon në orare të përshtatshme për</p>

shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim; Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.	studentet dhe pedagoget. Oraret e shërbimit ishin të afishuara në mjediset e UNYT dhe në faqen e internetit. Oraret janë të përshtatshme për studentët dhe biblioteka ofron shërbim dhe në fundjavë.
---	--

Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.

Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve; Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit; Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm; Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.	Nga të dhënat e detajuara të RVB, dokumentacioni i dorëzuar në ASCAL dhe vizita në IAL konstatuam që institucioni ka hapësira të mjaftueshme si: salla leksioni të pajisura me mjete audiovizive, salla seminaresh, laboratorë informatike, sallë konferencash, bibliotekë, palester, ambiente për pushim të studenteve etj., të cilat mundësojnë realizimin e PS. [Aneks 32] Sallat e leksioneve e seminareve janë të pajisura me të gjitha mjetet e përshtatshme për një proces mësimor efektiv, duke respektuar të gjitha standardet. Në funksion të programeve të studimit janë tre laborator informatike me 97 kompjutera, të cilat përdoren dhe për nevojat e programeve të tjera të studimit. Laboratorët kanë pajisjet e nevojshme dhe programet kompjuterike në përputhje me kërkesat e programit të studimit. [Aneks 29]
---	--

Konkluzionet e vlerësimit:

Mbështetur në vlerësimin e dhënë për secilin nga standardet GVJ konkludon:

1. UNYT ka siguruar infrastrukturën e nevojshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë dhe realizimin e programeve të studimit. Në shërbim të studentëve dhe personelit ka gjithashtu hapësira për shplodhje dhe zbavitje.
2. Në dispozicion të studentëve është biblioteka, e cila disponon literaturë bazë dhe ndihmëse në funksion të mësimdhënies në këtë PS. Studentët mund të aksesojnë literaturë online, e cila mundësohet përmes abonimeve vjetore, por dhe bashkëpunimit me Empire State Collage.
3. UNYT ka 3 laboratore informatike, të cilat kanë të gjitha pajisjet dhe programet e nevojshme kompjuterike dhe që mund të shfrytëzohen dhe për këtë PS.

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Menaxhimi i burimeve financiare bëhet nga Zyra e Financës, e cila është e ngarkuar për zbatimin e politikës financiare, në përputhje me buxhetin vjetor të miratuar. [Aneks 1, neni 45] Personeli i zyrës është: 2 specialistë dhe drejtori. Disa nga funksionet kryesore që kryen kjo zyrë janë: kontrollon të dhënat mbi të ardhurat dhe pagesat, mban kontabilitetin e UNYT; përpilon raporte financiare dhe bën parashikimet buxhetore; menaxhon pagesat, kontratat dhe marrëdhëniet me zyrën e tatim taksave, etj. Kontabiliteti i institucionit mbahet në

përputhje me Standardet Kombëtare të Përmirësuara të Kontabilitetit. [RVB fq.34-35, Aneks 6.3] Burimet financiare të UNYT përbëhen nga tarifatat e studimeve që studentët paguajnë, të ardhura nga projekte kërkimore si Erasmus+, IPA dhe RRPP, si dhe të ardhura nga aktivitete të tjera si p.sh të ardhurat nga qeradhënia, kafe, etj., të cilat përdoren për të mbështetur aktivitetin e institucionit. Informacioni financiar i paraqitur në RVB është në nivel institucioni dhe jo specifik për programin e studimit në proces vlerësimi. [Aneks 6.4]

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje):

Burimet e të ardhurave për UNYT janë: grantet kërkimore, tarifatat e shkollimit dhe aktivitetet tregtare. Peshat mesatare e këtyre burimeve në të ardhurat totale të institucionit, për periudhën 2012-2017 është si më poshtë: (bazuar në të dhënat e tabelës 8, në RVB)

- Grantet për kërkim (2.65%)
- Tarifatat për dhe gjatë shkollimit (97.0%)
- Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj) (0.35%)

Për vitin 2017 të ardhurat nga grantet janë sa 5.5% e të ardhurave totale, të ardhurat nga tarifatat 94.48% dhe të ardhurat nga aktiviteti tregtar 0.02%. Të ardhurat totale të UNYT janë në rënie për të gjithë periudhën 2012-2017. Të njëjtën tendencë kanë dhe të ardhurat nga tarifatat për dhe gjatë shkollimit. Ndërsa të ardhurat nga grantet për kërkim kanë tendencë në rritje. Shuma totale e granteve të marra për periudhën 2015-2017 ka qënë rreth 52 milionë lekë. [Aneks Tabela 8]

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

Për periudhën 2012-2017 mesatarisht rreth 50.5% e shpenzimeve të kryera në nivel institucioni janë për pagat, rreth 4% janë për investime dhe rreth 44.4% për shpenzime të tjera operative. Kosto e studimit për student për vitin akademik 2017-2018 ka qënë 4,055 Euro/vit. Kosto e studimit për studentë për vit akademik ka ndryshuar për çdo vit për të gjithë periudhën midis dy akreditimeve. Në tre nga 6 vitet e marra në shqyrtim kosto ka qënë më e lartë se 5,100 Euro. [RVB fq.36]

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Gjatë vizitës në institucion nuk kërkua dokumentacion shtesë.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	
Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;	UNYT bën auditim të jashtëm çdo vit. Raportet e auditit paraqesin situatën financiare për të gjithë aktivitetin e institucionit dhe pasqyrat financiare hartohen në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara. [Aneks 6.3]
Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të	Institucioni ka realizuar në vite dhe auditime të brendshme për pjesën financiare. [Aneks 6.2] Në pasqyra paraqiten të gjitha detyrimet financiare afatshkurtëra dhe afatgjata të

<p>programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	<p>institucionit, pagat e personeli, shpenzimet operative, tarifat që u paguhen universiteteve partnere. Raporti i auditit ka një pasqyrë të qartë me të gjitha burimet e të ardhurave [Aneks 6.4] Për projektet dhe grantet kërkimore përgatiten raporte të vecanta sipas kërkesave të donatorit apo burimit të financimit. [Aneks 6.5] Mbjajtja e kontabilitetit në nivel institucioni nuk e mundëson analizën e eficiencës së përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve.</p>
<p>Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>	<p>Për vitin 2017 institucioni ka paraqitur pasqyra financiare, ku reflektohen të ardhurat nga burime të ndryshme [Aneks 6.4]</p> <p>UNYT ka paraqitur raporte financiare të çertifikuara nga auditues të jashtëm vetëm për vitin 2017. [Aneks 6.3]</p> <p>Për të gjithë periudhën pjesa më e madhe e të ardhurave është siguruar nga tarifat e shkollimit. Të ardhurat nga tarifat kanë ardhur në rënie për të gjithë periudhën 2012-2017, megjithëse tarifat janë rritur. <i>Aktualisht qëndrueshmëria e institucionit varet shumë nga numri i studentëve që do të regjistrohen në programet e studimit.</i></p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p>	
<p>Mbështetur në vlerësimin e dhënë për secilin nga standardet GVJ konkludon:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. UNYT e dokumenton veprimtarinë e tij përmes pasqyrave financiare, të cilat janë audituar nga auditues të jashtëm, për të gjithë periudhën midis dy akreditimeve. 2. Pjesa dërrmuese e të ardhurave sigurohet nga tarifat e shkollimit të cilat janë rritur në të gjithë periudhën midis dy akreditimeve. Qëndrueshmëria financiare e UNYT është e ndërvaruar nga numri i studentëve. <p><i>Rekomandohet që IAL të sigurojë të ardhura nga burime të tjera për të rritur qëndrueshmërinë financiare.</i></p>	

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

GVJ, pasi analizoi RVB, dokumentacionin e vënë në dispozicion nga UNYT si edhe atë të mbledhur gjatë vizitës në institucion, konkludoi jo vetëm mbi rëndësinë që institucioni i kushton sigurimit të cilësisë, por mbi procesin e plotë të institucionalizuar të sigurimit të brendshëm të cilësisë në institucion. Komisioni për Garantimin e Standardeve të Cilësisë së Institucionit (KoGaSCI) është struktura përgjegjëse për hartimin dhe garantimin e zbatimit të politikave, strategjive dhe procedurave në përputhje me Kodin e Cilësisë si

edhe në përputhje me statutin e UNYT, sipas të cilit rritja cilësore e mësimdhënies dhe e mësimnxënies dhe përmirësimi i praktikave të sigurimit të cilësisë janë ndër objektivat kryesore.

Komisioni i cili përbëhet nga Kryetari, 5 anëtarë të tjerë të cilët përfaqësojnë çdo fakultet si dhe trupën studentore si edhe një ekspert i jashtëm, realizon funksionet e tij në përputhje me Manualin e Cilësisë, i cili është ripunuar në vitin 2018.

Disa nga funksionet kryesore të Komisionit në bashkëpunim me Koordinatorin e Sigurimit të Cilësisë janë vlerësimi periodik i rezultateve e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore, garantimi i përputhshmërisë me kuadrin ligjor kombëtar si dhe arritja e përsosmërisë akademike duke respektuar standardet më të larta të cilësisë. Pjesëmarrja në projekte dhe partneritete ndërkombëtare siç është dhe përfshirja në projektin Erasmus+: QainAL janë pjesë e strategjisë së UNYT për të garantuar cilësinë më të lartë të mësimdhënies dhe mësimnxënies.

GVJ konstatoi se institucioni përdor një seri instrumentash për të monitoruar dhe garantuar cilësinë e brendshme, të cilat janë :

- Vetë-vlerësimi,
- Vlerësimi nga studentët,
- Ndërmjet pedagogëve,
- Vlerësimi i Përgjegjësit të departamentit,
- Vlerësimi i Përgjithshëm.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:
 - Sa anketime kanë bërë me studentët
 - Sa studentë janë anketuar
 - Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë
 - Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm
 - Etj

Analiza e dokumentacionit përkatës evidentoi faktin se në përputhje me objektivat dhe misionin, si edhe me rregulloren dhe Kodin e Cilësisë, studentët jo vetëm janë grup interesi thelbësor në procesin e vlerësimit të cilësisë, por anketimet me ta zhvillohen çdo semestër. Në përputhje me metodologjinë e anketimit, për studentët e programit Master Komisioni i Sigurimit të Cilësisë organizon pyetësozin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi. Mbarëvajtja e procesit koordinohet nga Zyra e Studimeve Pasuniversitare dhe Koordinatorja e zyrës së sigurimit të cilësisë. Gjatë zhvillimit të anketimit, në ambjentet ku studentët plotësojnë vlerësimet e tyre, nuk lejohet prezenca e personelit akademik duke u ruajtur plotësisht anonimat i studentëve.

Të dhënat e anketimit përpunohen tërësisht nga ana e personave përgjegjës për statistikën në UNYT, ndërsa rezultatet e përfuara vihen në dispozicion të Komisionit për Garantimin e Standardeve të Cilësisë së Institucionit duke respektuar konfidencialitetin e plotë të informacionit si dhe rishikohen në nivel departamenti.

Ato kanë shërbyer si një burim i rëndësishëm për të nxjerrë konkluzione mbi cilësinë e punës të çdo pedagogu, sidoqoftë institucioni përdor edhe instrumentë të tjerë për të shmangur subjektivizmin në vlerësim.

Të gjithë studentët marrin pjesë në vlerësim. Të gjitha rezultatet përpunohen dhe analizohen. Informacionet që hedhin dritë mbi mundësinë e problemeve analizohen më tej, dhe vetëm në rastet e përputhjes të të dhënave me ato të përftuara nga përdorimi i instrumentave të tjerë, institucioni planifikon mënyrën e trajtimit.

Kontrolli i brendshëm i cilësisë

GVJ konstatoi se kontrolli i brendshëm i cilësisë është një proces kompleks. Siç edhe u nënvizua më lart, në përputhje me Manualin e Cilësisë, instrumentat e përdorur janë:

- Vetë-vlerësimi,
- Vlerësimi nga studentët,
- Ndërmjet pedagogëve,
- Vlerësimi i Përgjegjësit të departamentit,
- Vlerësimi i Përgjithshëm

Në përfundim të vlerësimit kompleks, Drejtuesi i Programit për MSc në Administrim Biznesi është përgjegjës për hartimin e raportin vjetor për mësimdhënien, të nxënëit dhe shkallën e zbatimit të standardeve të cilësisë, nëpërmjet përgatitjes të Raportit të Paanshmërisë, Transparencës, Krahasueshmërisë dhe Auditimit.

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti

GVJ gjykon që përgjegjësitë janë në lidhje me monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë janë të shpërndara në të gjitha strukturat, përgjegjëse për mbarëvajtjen e procesit mësimor, komponent thelbësor i misionit të institucionit.

Përveç Komisionit për Garantimin e Standardeve të Cilësisë së Institucionit (KGSC), dekani, shefi i departamentit, vetë pedagogët si edhe studentët ndajnë përgjegjësi të ndryshme në përputhje me kompetencat e tyre institucionale.

Dekani është i përfshirë në vendimmarrjen në lidhje me masat për sigurimin e cilësisë.

Shefi i Departamentit është i përfshirë në analizën e informacioneve mbi cilësinë si edhe në vendimmarrjen mbi politikat që duhet të ndërmerren për të garantuar cilësinë.

Pedagogët janë objekt dhe subjekt, sepse ndërsa mbajnë përgjegjësinë kryesore në zbatimin e politikave që garantojnë cilësinë, janë gjithashtu edhe subjekt i vlerësimit të efektivitetit të politikave.

Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

GVJ konstatoi se ndonëse institucioni ka patur mekanizma për vlerësimin e cilësisë, struktura e institucionalizuar u krijua pas akreditimit të parë në 2013. Gjithashtu, së bashku me përmbushjen e rekomandimeve të akreditimit të parë, u krijua edhe komisioni i sigurimit të cilësisë, që ndjek të gjithë procesin e sigurimit të cilësisë.

Pasi analizoi dokumentacionin mbi përdorimin e instrumentit të Vetëvlerësimit, GVJ vlerësoi se Vetëvlerësimi, si hapi fillestar i sigurimit të cilësisë, realizohet nga çdo pedagog në fund të vitit akademik. Në këtë proces profesorët vlerësojnë vetvehten sipas disa komponentëve si cilësia dhe metodologjia e mësimdhënies në

auditor, raporti i ndërtuar me studentët, sigurimi i ndihmës, konsultimit e udhëheqjes, puna kërkimore e tij, përfshirja e studentëve në punë kërkimore si edhe shërbime të tjera.

Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

GVJ vlerësoi faktin se institucioni në përputhje me synimet e tij për rritjen e vazhdueshme të cilësisë, zbaton një qasje që udhëhiqet nga synimi për ofrimin e zgjidhjeve më të mira e më të përshtatshme për institucionin në procesin e realizimit të misionit të tij. Ndonëse në përgjithësi, studentët vlerësojnë pozitivisht përgatitjen, profesionalizmin dhe motivimin e pedagogëve, ka patur raste edhe të komenteve në lidhje me njohuritë e kufizuara në gjuhën e huaj ose të vështirësive në komunikim, sidomos për pedagogë të rinj. GVJ konstatoi se institucioni ka aplikuar qëndrime të diferencuara në përputhje me rastet, gjithsesi kurdoherë zgjidhje të studjuara dhe të udhëhequra nga mirëkuptimi dhe bashkëpunimi.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

- Shembull i formularit të vlerësimit të studentëve.
- Formularë të vlerësimit të kolegëve.
- Formular i Performancës të Vlerësimit Individual.
- Raporti Vjetor i departamentit.
- Raporti i Paanshmërisë, Transparencës.
- Tabela e Vlerësimeve të profesorëve nga studentët.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <p>a. Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve;</p> <p>b. Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurikulës, të të mësuarit;</p> <p>c. Pyetje konceptuale;</p>	<p>Institucioni bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion por edhe në takimet dyditore me grupet e ndryshme, rezulton se ka një qasje pozitive drejt cilësisë. Për këtë synon të përafrojë me metodologji vlerësimi apo synon drejt përdorimit të instrumentave dhe treguesve matës.</p> <p>Nga takimet në institucione me drejtues të njësisë së sigurimit të cilësisë, por edhe me drejtues të njësisë bazë (departament dhe fakultet), si dhe nga takimi me stafin u konfirmua se përdorimi i vetëvlerësimeve, i kthyer tashmë në një proces të përvitshëm, është konsideruar si instrumenti kryesor i cili siguron një informacion të plotë mbi atë çka perceptojnë dhe gjykojnë studentët.</p> <p>Institucioni aplikon një instrument efektiv në nivel fakulteti që tregon vlerësimin me pikë të pedagogut. Ndonëse ky është një instrument i ri, ka ndikuar në mbledhjen e të dhënave dhe realizimin e analizave efektive.</p> <p>GVJ gjykon që institucioni përdor metodologji rigorozisht shkencore vlerësimi, si një pjesë e një procedure të institucionalizuar, rezultatet e të cilës</p>

<p>d. Intervista;</p> <p>e. Etj.</p> <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <p>a. Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj);</p> <p>b. Dëgjime në auditor;</p> <p>c. Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë;</p> <p>d. Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale;</p> <p>e. Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatet, projektet, provimet, etj.);</p> <p>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</p> <p>g. Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës;</p> <p>h. Etj.</p>	<p>përfshihen në vetëvlerësimin institucional.</p> <p>Në lidhje me metodat e vlerësimit. GVJ gjykon që institucioni përdor metoda të tërthorta dhe të drejtpërdrejta, përkatësisht: Sondazhe të studentëve, si të atyre që ndjekin programet, ashtu edhe të të diplomuarve, sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit si edhe nëpërmjet pyetjeve konceptuale.</p> <p>Sa i përket metodave të drejtpërdrejta, GVJ konstatoi se institucioni përdor të gjitha llojet e metodave, siç janë të përcaktuara tek standartet.</p> <p>Ndonëse nga diskutimet me stafin akademik dhe studentët, u qartësua roli i studentëve në vlerësimin e pedagogëve, të dhënat e ofruara nuk reflektojnë një analizë cilësore të rezultateve, si për shembull se çfarë problemesh janë evidentuar, por është paraqitur vetëm një përmbledhje e disa përgjigjeve.</p> <p>Por diskutimet me stafin akademik si edhe me stafin e KGSC, që monitoron procesin siguron cilësinë e mbarëvajtjes së këtij procesi, treguan se institucioni reagon nëpërmjet masave dhe kur është e nevojshme, nëpërmjet politikave për çështje të evidentuara gjatë vlerësimit.</p>
<p>Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>GVJ konfirmon se institucioni publikon rezultatet e vlerësimit si edhe ato që synon të arrijë, të cilat janë lehtësisht të aksesueshme.</p>
<p>Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>GVJ konfirmon se rezultatet e vlerësimeve të kryera si pjesë e procedurës dhe në përputhje me Manualin e Cilësisë janë objekt i analizës vjetore, si edhe shërbejnë për të hartuar politika që në mënyrë efektive garantojnë cilësinë e procesit mësimor dhe të rezultateve të tij.</p>
<p>Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</p>	

<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>GVJ gjykon që institucioni ka plotësuar standardet institucionale të përcaktuara në këtë rubrikë, sepse:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Përdor me efektivitet instrumentat e duhura për vlerësimin e cilësisë. ▪ Ka hartuar politikë të institucionalizuar për monitorimin, matjen dhe raportimin e cilësisë. ▪ Vëzhgon me vëmendje ecurinë e programeve akademike si edhe ndërmerri masa për ndryshimin dhe përmirësimin e tyre. ▪ Përpiqet të ndërgjegjësojë personelin akademik, nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme, pjesëmarrjes në projekte si edhe me instrumente të tjerë të motivimit individual, mbi rëndësinë e rritjes së vazhdueshme të cilësisë. ▪ Ka hartuar dhe zbaton strategji për përmirësimin e cilësisë.
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>GVJ, bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion por edhe në takimet dy ditore me grupet e ndryshme, rezulton se UNYT ka një qasje pozitive drejt cilësisë, e cila shprehet nëpërmjet:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Synimit për të zbatuar metodologji vlerësimi që përdorin instrumentave dhe tregues të integruar. 2. Institucionalizimit të përgjegjësisë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë. 3. Nxitjes dhe aplikimit të një politike gjithë përfshirëse dhe informuese për të gjithë aktorët dhe grupet e interesit. <p>Sidoqoftë, për të mbështetur sfidat me të cilat përballlet ky institucion, që kanë të bëjnë jo vetëm me krijimin dhe mbajtjen e standardeve, por edhe me riorganizimin e ri të këtij programi, rekomandojmë në të ardhmen nevojën e një platforme të re, të gjerë dhe ndërvepruese të sigurimit dhe mbajtjes së cilësisë, të shoqëruar me tregues konkretë të përmbajtjes së këtij treguesi.</p>	

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Misioni i programit Master Shkencor në Administrim Biznes është formuluar në përputhje me Misionin e UNYT, i cili udhëhiqet nga qëllimi bazë i përgatitjes së studentëve cilësorë, të aftë që të orientohen menjëherë përballë tërësisë së informacioneve dhe specifikave të sektorëve e degëve ku ata specializohen e të marrin vendime të sakta, në përputhje me kërkesat e detyrimeve e përgjegjësisve që do të duhet të zbatojnë.

Programi Master Shkencor në Administrim Biznesi e arrin këtë synim nëpërmjet ofrimit të studimeve në gjashtë drejtime: të Përgjithshëm, Menaxhim, Menaxhim i Burimeve Njerëzore, Marketing, Menaxhim i sistemeve të informimit dhe Bankë. Programi i studimit është ndërtuar duke harmonizuar aspektet teorike dhe praktike.

GVJ pas analizës së dokumentacionit përkatës, konstatoi se Programi në përgjithësi synon të pajisë studentët me aftësi praktike të zgjidhjes së problemeve në biznes nëpërmjet ofrimit të njohurive të avancuara në tema të veçanta të biznesit.

Pjesë përbërëse e programit është dhe kërkimi shkencor i cili është një ndihmesë për studentët që do të ndjekin studimet doktorale. Duhet theksuar se ky program është i mundur të ndiqet dhe nga studentë të cilët nuk kanë formim të mëparshëm në fushën e biznesit.

Mundësitë e karrierës pas përfundimit të Programit Master Shkencor në Administrim Biznesi janë të shumëllojshme duke nisur nga Menaxher i përgjithshëm e deri në mësimdhënie në institucione të arsimit të lartë. Projektet kërkimore janë komponente e rëndësishme e studimeve Master duke përfunduar me punimin e tezës së diplomës e cila kontrollohet nëpërmjet një software specifik për të shmangur rastet e plagjiaturës. Diplomimi në Master Shkencor në Administrim Biznesi kërkon një mesatare kumulative prej jo më pak se 3.67.

Programi mësimor funksionon si një kontratë pune ndërmjet studentit dhe pedagogut. Ai përfshin përbajtjen e lëndës, përcaktimin e qartë të kritereve të vlerësimit dhe detyrimet e studentit. Elementët kryesorë të mësimin janë: leksionet, detyrat e kursit, projektet e kursit, praktikat profesionale, punë laboratorike, esetë, provimet, provimet e formimit, temat e diplomës etj.

Stafi i angazhuar për mësimdhënie në këtë program është i kualifikuar dhe kryesisht me eksperiencë ndërkombëtare. Gjithashtu profesorë që vijnë nga industria dhe bota e biznesit janë angazhuar në mënyrë që t'ju ofrojnë studentëve ndërthurje të njohurive akademike me ato praktike. Të dhëna të detajuara mbi numrin e stafit të angazhuar në program dhe gradat shkencore janë pasqyruar në Aneks. Literatura dhe materialet e tjera mbështetëse zgjidhen duke ju referuar kohës kur janë botuar, kredibilitetit të autorit dhe të përkthyesit si dhe nivelit të shtëpisë botuese përkatëse. Tekstet e përzgjedhura miratohen nga shefi i departamentit para çdo fillimi të vitit akademik. Gjithashtu koordinatoja e programit bën projeksionet për literaturën e nevojshme dhe porosinë në bibliotekën e shkollës, e cila jo vetëm që është e pasur në literaturë, por edhe e aksesueshme online, duke lehtësuar përgatitjen cilësore të studentëve.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

GVJ, hulumtoi dhe analizoi dokumentacionin e vënë në dispozicion, i cili u pasurua me rezultatet e diskutimeve gjatë vizitës dy ditore në institucion dhe konstatoi se programi që vlerësohet ka filluar në vitin 2008 me qëllim që të kontribuojë në formimin e specialistëve të aftë të kontribuojnë në zhvillimin e ekonomisë së tregut duke realizuar edhe objektivat e karrierës së tyre personale. GVJ konstatoi që institucioni e realizon qëllimin e tij nëpërmjet:

- Ofrimit të studentëve metodat e kërkimit shkencor të pavarur bashkëkohore, në përputhje me standartet;
- Sigurimin e kushteve për përdorimin e literaturës bazë dhe plotësuese, cilësore, nga autorë dhe shtëpi botuese nga më të spikaturat e fushës së biznesit, të njohura në nivel kombëtar e ndërkombëtar;
- Pajisjen e studentëve me aftësinë për të mbajtur qëndrim analitik të ndërthurur me eksperiencë të rëndësishme praktike;

- Zhvillimin e leksioneve dhe seminareve me metoda e forma didaktiko-pedagogjike moderne e interaktive, duke përdorur gjerësisht prezantimet problemore, analizën logjike e sasiore, analizat krahasuese e kontekstuale, pjesëmarrjen aktive të studentëve në leksione e seminare, debatin e improvizuar, etj;
- Zhvillimin e kompetencave në aplikimin dhe interpretimin e politikave të biznesit dhe strategjive të menaxhimit;
- Trajnimin e vazhdueshëm të stafit pedagogjik dhe atij ndihmës administrativ nëpërmjet seminareve, konferencave dhe aktivizimit në projekte të ndryshme.

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

- 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor
- 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor

(të ekuivalentuara sipas formës së organizimit të mësimdhënies në Master Shkencor).

GVJ u njoh me formën e organizimit të studimeve akademike në Master Shkencor në Administrim Biznesi, program i cili zgjat dy vjet, ndërsa mësimi zhvillohet vetëm në fundjavë dhe një here në dyjavë, në sesione 20 orëshe, përgjatë 5 semestrave, nga të cilët në semestrat 1, 2 dhe 3 zhvillohen vetëm lëndët e detyrueshme, përkatësisht 3 lëndë në secilin semestër. Në semestrin e 4-rt zhvillohen lëndët e profilit, ndërsa në semestrin e fundit zhvillohen dy lëndët e tezës përfundimtare.

Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë

Siç e tregon edhe tabela 11, lëndët që zhvillohen në Programin që vlerësohet janë të kategorizuara në 5 grupe, përkatësisht: përgatitore, themelore, të profilit, të tezës si edhe vetë teza, gjithsej 16 lëndë të vlerësuara me kredite dhe 3 lëndë, lëndë "Bazë Përgatitore" të pa vlerësuara me kredite. Programi, i vlerësuar sipas të dy sistemeve të matjes, atij europian dhe amerikan, përfshin 60 kredite sipas sistemit Amerikan dhe 120 kredite sipas atij European.

Pesha specifike e veprimtarive formuese është e njëjtë në profilet e ndryshme, siç e dëshmon dhe tabela 11 në aneks.

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

- Për leksionet 40 orë në auditor dhe 110 orë punë e pavarur e studentit
- Teza e Masterit 20 orë në auditor dhe 730 orë punë të pavarur.

GVJ pasi u njoh me mënyrën e përcaktimit të krediteve, nëpërmjet RVB, dokumentacionit përkatës si edhe nga bisedat me drejtuesit e programit, gjykon që Veprimtaritë Formuese janë të përfshira në mënyrë korrekte në Planin Mësimor dhe në përputhje me standartet. Disiplinat e Formimit të Përgjithshëm: 6 kredite; Disiplina të Formimit Karakterizues: 48 kredite; Disiplinat me zgjedhje: 24 kredite; Njohuri të tjera formuese: 12 kredite dhe Teza e Masterit: 30 kredite, gjithsej 120 kredite.

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara (Plotësoni Tabelën në Aneks)

GVJ konstatoi se nuk paraqiten ndryshime të planit mësimor krahasuar me planin e licensuar pasi ato përbëjnë lëndët bazë mbi të cilat studenti duhet të aftësohet. Gjashtë profilet e ofruara në këtë program japin mundësinë e zgjedhjes midis një game të gjerë lëndësh duke u bazuar në preferencat individuale të secilit student, në perspektivën e karrierës së ardhshme apo në kërkesat e tregut të punës. Programi është tejet efikas në përputhje të plotë me kërkesat e studentëve dhe të tregut.

Nga analiza e të dhënave të Dosjes së vetëvlerësimit si dhe nga vizita në institucion dhe dokumentacioni i paraqitur rezulton se ka një vijim normal dhe të strukturuar të organizimit të programit dhe mbarëvajtjes për ta monitoruar dhe manaxhuar në mënyrën e duhur. Nuk ka ndryshime që mund të çenojnë përmbushjen e standardeve që lidhen me këta tregues.

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës (Plotëso Tabelën ne Aneks)

GVJ u njoh me dosjet e personelit akademik, në të cilat ishin të pasqyruara të gjitha të dhënat e nevojshme, individuale, profesionale dhe shoqërore. GVJ gjykon që në shpërndarjen e ngarkesës mësimore janë mbajtur parasysh cilësitë akademike, profesionale si edhe eksperiencia në mësimdhënie, përkatësisht: kualifikimi i personelit akademik; fusha e ekspertizës për secilin anëtar; norma që duhet plotësuar në bazë të kontratës së lidhur me universitetin.

Personeli akademik i cili angazhohet në lëndët e ndryshme mësimore është në varësi të nevojës dhe të preferencave të studentëve për lëndët e ndryshme.

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetësimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Analizë e cilësisë së syllabuseve

GVJ konstatoi se Institucioni analizon në mënyrë të vazhdueshme cilësinë e syllabuseve. Institucioni ka përpunuar një format të përcaktuar për Syllabusin, ndonëse pedagogët janë të lirë në ndërtimin e përmbajtjes së kursit. Ky fleksibilitet nuk përjashton diskutimin me Koordinatorin e Programit rreth çështjeve themelore që duhet të përfshihen në program. Studentët njihen me programin e studimit si edhe rastet studimore që përbëjnë bazën e diskutimeve akademike, 2 deri 3 javë përpara se sa të zhvillohet tematika e përcaktuar me qëllim që të kenë kohë të mjaftueshme në dispozicion për t'u përgatitur. Sidoqoftë, përmbajtja e temave është objekt ndryshimi e përmirësimi të vazhdueshëm, për të ofruar njohuri sa më bashkëkohore.

Metodologjia e mësimdhënies e zbatuar është e përshtatshme, e kuptueshme dhe në përputhje me kërkesat e audiencës.

Një nga përparësitë dhe praktikat e mira është liria akademike, gjerësisht e nxitur nga drejtuesit e programeve, me qëllim rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies. Të gjithë pedagogët kanë mundësi që të rifreskojnë modulet në përputhje me zhvillimet e fundit si edhe të përshtasin përmbajtjen, duke konsoliduar tematikën e lëndës.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p>	<p>GVJ konfirmon se institucioni ofron programe të akredituara, të organizuara në module dhe të vlerësuara sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve si edhe sipas sistemit amerikan.</p>
<p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>GVJ konstaton se sasia e përgjithshme e krediteve që përfton një student është 120, në programin e Masterit Shkencor, pavarësisht nga profili. Këto kredite janë të shpërndara përgjatë 2 viteve ose 5 semestrave. Teza e masterit vlerësohet me 18.3% të krediteve.</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p>	<p>GVJ konsideron përparësi të programit master Shkencor ofrimin e njohurive bashkëkohore, në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit dhe strategjinë e zhvillimit të tregut. Këto njohuri ofrohen sipas një metodologjie mësimdhënie efektive, në të cilën njohuritë teorike dhe praktike janë të mirëharmonizuara.</p>
<p>Kriteri 3 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p>	<p>Programi “Master Shkencor” ndonëse është ndërtuar mbi bazën e programit Bachelor, synon të zgjerojë njohuritë në aspektin sasior dhe cilësor, gjë e cila manifestohet tek numri më i madh i profileve si edhe larmishmëria e tyre.</p>
<p>Kriteri 4 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p>	<p>NA</p>
<p>Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p>	<p>GVJ vlerëson se institucioni ka përgatitur të gjitha kushtet për paisjen e studentëve me njohuri e kompetenca të përgjithshme e profesionale, të cilat mund të zgjerohen e thellohen më tej, në varësi nga kërkesat e tregut si edhe objektivat e karrierës individuale. Profilet e ofruara nga institucioni jo vetëm që përbëjnë risi për tregun shqiptar, por edhe cilësia e lartë e ofrimit të tyre iu hap rrugën studentëve si për të thelluar njohuritë në ciklin e tretë të studimeve, ashtu edhe për të kontribuar në çdo fushë të zhvillimit ekonomik të vendit. Përveç kësaj, e gjithë qasja akademike e aplikuar nga institucioni dëshmon për përpjekjet e institucionit që të përgatisë specialistë të aftë për tregun global të ekonomisë dhe të punës.</p>
<p>Kriteri 6 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p>	
<p>Kriteri 7 Programet e studimeve “Master</p>	

<p>Profesional” kanë objektiva të qartë profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	
<p>Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p>Kriteri 2 Metodatat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>GVJ gjykon që qëllimi dhe objektivat e programeve të studimit përputhen me përmbajtjen e tyre, me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen si edhe me nivelin e audiencës. Përpjekja e institucionit për të mbajtur të njëjtën cilësi në hyrje të studentëve, jo vetëm është e justifikuar, por i shërben plotësisht efektivitetit të studimeve të ofruara në këtë institucion.</p>
<p>Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavejeçare dhe praktikatat e mira të vendeve europiane;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>Për vetë natyrën e studimeve të ofruara në institucion si edhe mënyrën e organizimit të aktivitetit, qasja e institucionit është përafërimi me tregun ndërkombëtar.</p> <p>GVJ gjykon që dimensionin ndërkombëtar është përparësia më e fuqishme e programit, e vlerësuar si e tillë edhe nga tregu i kërkesës.</p> <p>GVJ konfirmon se programet përputhen plotësisht me legjislacionin shqiptar si edhe objektivat për zhvillimin e arsimit të lartë në Shqipëri.</p>
<p>Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p> <p>Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>Dokumentacioni i shqyrtuar dhe vizita në institucion mbështesin argumentin se programi i Masterit Shkencor udhëhiqet nga qasja e aftësimin profesional dhe kërkimit shkencor. Thuhet të gjithë studentët janë të përfshirë në projektet e kërkim zhvillimit, tregues i qartë i qasjes akademike të institucionit.</p> <p>Personeli akademik gjithashtu angazhohet në punën kërkimore, i nxitur nga motive akademike ose edhe nga motive të karrierës personale. Pavarësisht motivit, rezultatet e punës kërkimore përdoren nga institucioni për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies.</p>
<p>Standardi I.7 - Programet e studimeve “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.</p>	

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.</p>	
<p>Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar; kërkesat e punëdhënësve; një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Pas diskutimeve të larmishme gjatë vizitës dy ditore në institucion, GVJ gjykon që megjithë qasjen e përshtatjes ndaj kërkesave të tregut, programet e studimeve nuk mbështeten plotësisht mbi nevojat e tregut. Në këtë praktikë, një ndikim të konsiderueshëm ka fakti që programi, për shkak të dimensionit ndërkombëtar, duhet të përputhet me kërkesa të tregut shqiptar dhe atij global, gjë që paraqit sfida akademike dhe praktike. Por, duhet të nënvizohet edhe fakti që institucioni nuk ka ndërmarrë studim të mirëfilltë tregu, gjë e cila është një objektivi i të ardhmes së afërt të institucionit.</p>
<p>Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>GVJ gjykon që programet e studimit nuk bien ndesh me interesat kombëtare.</p>
<p>Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve “Master i Shkencave” realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;</p>	<p>Siç edhe dëshmohet nga tabela e paraqitur tek Pika 7, të gjitha programet e profileve të ofruara realizohen me 120 kredite, përgjatë dy viteve akademike.</p>
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve “Master Profesional” realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.</p>	
<p>Kriteri 3 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës “Master i Shkencave”. Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të</p>	

studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë).	
Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.	
<p>Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;</p> <p>Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.</p>	GVJ gjykon që informacioni i ofruar për programet e studimeve është i plotë, i qartë, i argumentuar dhe lehtësisht i konsultueshëm nga studentët. Studentët informohen rreth programit përpara se sa të fillojë semestri përkatës, gjë e cila lehtëson komunikimin si edhe konsultimin rreth çështjeve kritike. Institucioni përdor të gjitha metodat e mundshme për të konsultuar studentët rreth programit, si nëpërmjet formave të shkruara ashtu edhe nëpërmjet Sistemit Elektronik.
Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.	
<p>Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;</p> <p>Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve “Master i Shkencave” janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.</p>	<p>Ndonëse tema e diplomës është ndërtuar mbi punën e pavarur e cila zë një peshë specifike të konsiderueshme kundrejt totalit, institucioni përdor disa instrumente për të shpjeguar mënyrën e diplomimit si edhe kërkesat që duhet të plotësojë çdo student. Për këtë qëllim, institucioni ka parashikuar 20 orë në auditor si edhe sigurimin e konsultimit të vazhdueshëm me udhëheqësin, me qëllim përfundimin e studimeve brenda afatit të përcaktuar.</p> <p>GVJ konfirmon që teza e Masterit është e barazvlershme me 30 kredite, në të gjitha profilet.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <p>GVJ gjykon që politikat e formimit të studentëve në këtë program, në të gjitha profilet e tij, janë bashkëkohore, gjithëpërfshirëse, efektive dhe të vlerësuara nga studentët. GVJ vlerëson se këto poliitka qëndrojnë në themel të reputacionit të institucionit, gjë që manifestohet edhe me shkallën e lartë të punësimit të studentëve.</p> <p>GVJ vlerëson se institucioni përdor instrumente të larmishëm për të nxitur përgatitjen sa më të lartë e cilësore të studentëve, gjë që manifestohet edhe nga nota mesatare e lartë e studentëve në fillim dhe përfundim të studimeve.</p> <p>GVJ vlerëson se zgjedhja e UNYT nga studentët është një zgjedhje e orientuar nga të evidenca mbi cilësinë e studimeve në këtë institucion si edhe e orientuar nga reputacioni i institucionit në treg.</p> <p>GVJ konkludon që megjithë qasjen e përshtatjes ndaj kërkesave të tregut, programet e studimeve nuk mbështeten plotësisht mbi nevojat e tregut. Në këtë praktikë, një ndikim të konsiderueshëm ka fakti që programi, për shkak të dimensionit ndërkombëtar, duhet të përputhet me kërkesa të tregut shqiptar dhe atij global, gjë që paraqit sfida akademike dhe praktike.</p>	

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësishë etj.

GVJ pasi u njoh me RVB si edhe me dokumentacionin mbështetës konstatoi se procesi i mësimdhënies i përafrohet sistemit amerikan të mësimdhënies, ndonëse metodologjia bazë e mësimdhënies mbështetet tek integrimi i leksioneve me seminarët. I gjithë programi përmban 120 ECTS. Ofrohen tre lëndë bazë për studentët e disiplinave të ndryshme, nëntë lëndë themelore, katër lëndë profili, dhe dy lëndë të lidhura me tezën e diplomës së Masterit. Seancat mësimore kanë kohëzgjatje prej 4 orësh me nga 10 minuta pushim midis tyre.

Mësimdhënia promovon metoda inovative, aktive dhe të orientuara drejt studentëve. Përdorimi i mjeteve didaktike është një tjetër element ndihmës për përçimin e dijes tek studentit. Përdoren gjerësisht prezantimet Power Point dhe forma të tjera të multimedias ndihmëse për procesin mësimor.

Vlerësimi i studentëve bëhet duke konsideruar disa tregues, ndërsa kandidati duhet të ketë një mesatare prej 70% për të përfunduar me sukses një lëndë. Nëse mesatarja është më e ulët se 70% atëherë studenti duhet të përsërisë lëndën. Çdo student duhet të paraqitet në provime dhe të shlyejë detyrimet ndaj kursit në mënyrë që vlerësimi i tij të quhet i suksesshëm. Para se studenti kandidat për titullin Master i Shkencave në Administrim Biznesi, të fillojë punën për tezën e masterit, ai duhet të sigurohet që mos të ketë më shumë se dy lëndë të mbetura nga semestrat e mëparshëm.

Siç parashikohet në politikat e institucionit, studenti duhet të dorëzojë tezën në datën e paracaktuar. Në rast të kundët dhe kur nuk ka asnjë arsye të pranueshme për vonesën, ai konsiderohet i pasuksesshëm. Studenti lejohet të mungojë vetëm në 20% të orëve të mësimi në auditor dhe duhet të paraqesë një arsye të vlefshme justifikuese për çdo mungesë.

Institucioni iu ka siguruar studentëve kushte mjaft të përshtatshme të studimeve akademike. Biblioteka e UNYT ofron literaturën më bashkëkohore në mbështetje të mësimnxënies dhe kërkimit shkencor.

Diskutimi me studentët, si ata që i kanë përfunduar studimet ashtu edhe ata që aktualisht po studiojnë nxori në pah konsideratën e tyre për cilësinë e mësimdhënies si edhe për të gjithë procesin akademik. GVJ konstatoi se reputacioni i UNYT kishte udhëhequr një pjesë të studentëve drejt zgjedhjes së tyre. Duke analizuar përgjigjet e studentëve të UNYT, GVJ konstatoi se jo vetëm zgjedhja e studentëve ishte plotësisht e ndërgjegjshme dhe e mbështetur në informacion mbi programet dhe cilësinë e tyre, por edhe se ky informacion kryesisht ishte rrjedhojë e punës së Njësishë Akademike për të promovuar vlerat e institucionit.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet:

- Leksione/Seminare/Ushtime: 560 orë në auditor
- Laboratore: 20 orë në auditor
- Praktikë profesionale: 200 orë
- Provime: 65 orë
- Gjithsej: 845

Format e kontrollit të njohurive

GVJ konstatoi se format e kontrollit të dijeve janë të larmishme. Institucioni nxit pjesëmarrjen e studentëve në diskutime në klasë, gjë e cila është edhe një format e vlerësimit të dijeve. Gjithashtu, studentëve iu kërkohet të hartojnë detyra kursi, analiza studimore të rasteve e situatave të ndryshme, projekte kërkimore dhe provimet

përfundimtare. Çdo detyrë kursi dhe punim i përgatitur nga studenti duhet të dorëzohet nëpërmjet një programi kompjuterik specifik për identifikimin dhe shmangien e plagjiaturës. Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm, ndërsa studentët informohen vazhdimisht për ecurinë e tyre.

Siç rezultoi nga shqyrtimi i RVB dhe dokumentacionit përkatës, vlerësimi përfundimtar i studentit është kombinim i disa treguesve, të cilët kanë peshë specifike të ndryshme, përkatësisht Pjesëmarrja aktive dhe ndjekja e kursit (10% e peshës), Detyra kursi, laboratore, prezantime etj (25% të peshës), Projekt kërkimor (25%) dhe Provimi final (40 %).

Sistemi i vlerësimit i aplikuar në institucion përmban vlerësim me Notë, Përqindje dhe Pikë GPA (shih tabela 17, Aneks). GVJ gjykon që niveli i kalueshmërisë është i lartë, gjë që dëshmon për qasjen e pakontestueshme të institucionit ndaj cilësisë së mësimnxënies.

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj

Diskutimet me studentët gjatë vizitës dy ditore në institucion konfirmuan faktin se institucioni bën përpjekje të vazhdueshme që të përfshijë studentët në projektet kërkimore të ndërmarra në nivel fakulteti. Sidoqoftë, GVJ konstatoi se studentët nuk kanë kurdoherë mundësi që ti përgjigjen nxitjes së institucionit për të marrë pjesë në projekte kërkimore për shkak të angazhimeve të tjera që lidhen drejtëpërsëdrejti me punën dhe zhvillimin e karrierës së tyre individuale.

Pjesëmarrja e studentëve në projekte të kërkimit e zhvillimit shkencor është një nga instrumentat me të cilat institucioni nxit formimin akademik të profesionistëve të ardhshëm. 2 studentë janë aktivizuar në sigurimin e ndihmës për përgatitjen e punimeve shkencore individuale të pedagogëve, ndërsa 81 të tjerë janë përfshirë në projekte shkencore në rang Departamenti.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

GVJ analizoi në thellësi dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse informacionet dhe evidencat që dëshmojnë për mbarëvajtjen dhe ecurinë e studentëve, që nga momenti i regjistrimit në institucion. Në këtë kontekst, GVJ konfirmon që kriteret e pranimit të studentëve në Programi Master i Shkencave në Administrim Biznes janë ndërtuar në përputhje me kërkesat e legjislacionit shqiptar, sipas të cilave, çdo aplikant duhet të zotërojë një diplomë universitare “Bachelor” nga një institucioni i akredituar, në studime biznesi ose në një disiplinë të përafërt. Studentët të cilët nuk janë diplomuar në biznes duhet të kryejnë programin bazë në mënyrë që të mund të vijojnë më studimet master në Administrim Biznes.

Gjithashtu, në përputhje me misionin e tij, si një institucion që synon thellimin e dijeve të fituara nga studenti në nivelin e parë të studimeve dhe aftësimin për shprehi të avancuara në administrim biznesi, UNYT i kushton kujdes të veçantë nivelit të njohurive të aplikantëve në gjuhën angleze, të cilët duhet të dëshmojnë zotërimin e

saj. Nëse aplikantët nuk e disponojnë një dëshmi të tillë, atëherë aplikanti i nënshtrohet një testi të gjuhës angleze të organizuar nga njësia e gjuhës angleze në UNYT. Kurset intensive të gjuhës angleze janë gjithashtu një mjet ndihmës i ofruar nga UNYT për përmirësimin e njohurive të studentëve.

Në ndihmë dhe në mbështetje të studentëve është edhe Zyra e Karrierës, e cila iu ofron studentëve këshillim në zgjedhjen e profileve dhe lëndëve, por gjithashtu i udhëheq në rrugën për të formuar profilin e tyre akademik e profesional.

GVJ, gjatë vizitës dy ditore në institucion u njoh me opinionet e studentëve dhe ish/studentëve që kanë përfunduar studimet në Master Shkencor në UNYT, të cilët lehtësisht konstatojnë ndikimin pozitiv të studimeve të ndjekura në UNYT dhe rritjes profesionale në punë, edhe në rastet kur UNYT nuk ka patur asnjë rol në punësimin e studentëve. Sipas studentëve, një nga praktikatat e mira të UNYT është investimi në “Kërkim e Zhvillim”, duke ndikuar në rritjen e kapaciteteve konkurruese të tyre, gjë që është risi për tregun shqiptar në zhvillim.

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

- Procedurat e pranimit të studentëve

Procedurat e pranimit në Master Shkencor kërkojnë nga studentët të paraqesin diplomën e shkollës së mesme dhe listën e notave, diplomën universitare Bachelor dhe transkriptin, CV-në, fotografi dhe kopje të kartës së identitetit dhe formatin e aplikimit. Komisioni i Pranimit i cili përbëhet nga anëtarë të fakultetit pasi analizon me kujdes dosjen e secilit kandidat, nivelin e anglishtes së tyre dhe dokumenta të tjera shtesë vendos për pranimin zyrtar të kandidatit në program.

- Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Studentët në përfundim të programit Master Shkencor në Administrim Biznes, rezultojnë me një formim të plotë dhe cilësor e me koncepte të qarta rreth menaxhimit dhe ekonomisë. Pas një formimi akademik teorik dhe praktik, ata janë të aftë të integrohen të tregun e punës duke dhënë një kontribut real në ekonominë dhe biznesin Shqiptar. UNYT aftëson studentët me dije të avancuara dhe bashkëkohore rreth modeleve më inovative të biznesit dhe pajis tregun e punës me individ të aftë për të qenë lider të suksesshëm në fushat e tyre përkatëse.

- Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare.

Numri i studentëve të regjistruar për herë të parë që nga viti akademik 2013-2014 e deri në vitin akademik në vazhdim, ka pësuar lëkundje të thella. Numri më i vogël i studentëve është regjistruar në vitin akademik 2014-2015, ndërsa numri më i lartë në vitin akademik në vazhdim (27 studentë). GVJ, ndonëse e diskutoi këtë problem edhe gjatë vizitës dy ditore, nuk arriti në përfundime se cilat janë arsyet që kanë ndikuar një mungesë të tillë stabiliteti. Pavarësisht regjistrimit të studentëve, institucioni nuk ka ndryshuar kriteret e pranimit dhe as notën mesatare në hyrje, e cila është mbi 7.2.

- Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare

GVJ konstatoi se në vitin 2017-2018 janë regjistruar 18 studentë, ndërsa në vitin 2018 janë diplomuar 8 studentë ose 44% me notë mesatare 7.82.

- Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

Ndonëse RVB informon se UNYT ka krijuar programe shkëmbimi me disa universitete, të cilat nxisin lëvizjet e studentëve në të dy kahet, të dhënat e analizuar nuk e mbështesin këtë politikë. Mbështetur tek të dhënat e siguruar nga institucioni, rezultojnë vetëm 1 student i transferuar në vitin 2018-2019.

Të dhëna për punësimin e studentëve

GVJ konstatoi se shkalla e punësimit të studentëve të diplomuar është absolutisht e lartë, 100%. Që në etapën e pranimit, studentët informohen mbi mundësitë e punësimit. Zyra e Karrierës e UNYT dhe Zyra "Alumni" janë ndihmesë e madhe për studentët duke ofruar pa pagesë shërbime këshillimi për karrierën dhe transferimin në tregun e punës. Ata mbajnë kontakte të ngushta me komunitetin e biznesit në Shqipëri dhe rajon. Qëllimi i Panairit të Punës i cili organizohet çdo pranverë nga UNYT është ofrimi i mundësive të praktikave të punës, punës me kohë të pjesshme dhe punësimit të plotë për studentët.

Numri total të diplomuarve

Numri total i të diplomuarve që nga viti akademik 2013-2014 është 81 nga 120 studentë të regjistruar ose 67%. Nuk ka të dhëna për numrin e të diplomuarve sipas profileve.

Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)

Numri total i të punësuarve në përputhje me diplomën është 68 studentë ose 84%.

Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)

Numri total i të punësuarve jo në përputhje me diplomën është 13 studentë ose 16%.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve "Master i Shkencave" apo "Master Profesional" zotërojnë së paku diplomën universitare "Bachelor" dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p> <p>Kriteri 2 Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;</p> <p>Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve "Master</p>	<p>GVJ mbështetur në analizën e dokumentacionit si edhe verifikimin e dosjeve dhe arkivës të zyrës së pranimeve konstatoi se institucioni është udhëhequr në të gjithë praktikën e tij nga legjislacioni Shqiptar, përkatësisht ligji nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi dhe ligji nr.80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë dhe në Republikën e Shqipërisë" dhe aktet nënligjore në fuqi. Për rrjedhojë, studentët që ndjekin programin e studimeve "Master Shkencor" zotërojnë diplomën Bachelor. Një pjesë e tyre i kanë përfunduar studimet në Nivel Bachelor në UNYT.</p> <p>GVJ gjykon që kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni janë plotësuar. Është përparësi e</p>

<p>Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit European të Gjuhëve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.</p>	<p>instiucionit mesatarja e lartë në hyrje, 7.2.</p> <p>Sa i përket kriterit të zotërimit të gjuhës angleze deri në përfundim të studimeve, në rastin e UNYT, ky kriter kërkohet të plotësohet nga studentët përpara fillimit të studimeve, për shkak të organizimit të mësimdhënies në gjuhën angleze.</p>
<p>Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>GVJ konstaton se Zyra e Karrierës, e cila tashmë është krijuar dhe funksionon me efektivitet, jo vetëm informon studentët për mundësitë për punësim, por i udhëheq me profesionalizëm drejt tregut të punës.</p> <p>Aktiviteti i këshillimit të karrierës është jashtëzakonisht i vlerësuar, siç rezultoi nga diskutimet me studentët gjatë vizitës dy ditore në institucion.</p> <p>GVJ gjithashtu vlerëson se studentët janë të mirë informuar dhe të qartë për procedurën ligjore të vlefshmërisë së diplomës, për akreditimin e programeve akademike si edhe për dimensionin ndërkombëtar që diploma ofron, përparësia më e fuqishme e UNYT.</p>
<p>Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p> <p>Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>GVJ, pasi u njoh me arkivën e zyrës së Pranimeve, konstaton se sistemi i mbledhjes, mbajtjes, përpunimit dhe raportimit të të dhënave është ndërtuar në përputhje me standartet shkencore si edhe në përputhje me nevojat e institucionit. Ky sistem i shërben plotësisht nevojave të institucionit, i cili orienton vendimmarrjen dhe politikat mbështetur në evidenca.</p>
<p>Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	

<p>Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p>Siç dëshmojnë stafi pedagogjik dhe studentët, aktiviteti i zyrës së ish Studentëve “Alumni”, është tejet i dobishëm për zgjerimin e rrjetit të bashkëpunëtorëve të institucionit si edhe përdorimin e tij me efektivitet.</p> <p>Komponent thelbësor i bazës të të dhënave është informacioni mbi studentët si edhe karrierën e tyre profesionale, si në drejtim të vazhdimit të studimeve në cikle të tjera, ashtu edhe në drejtim të punësimit.</p>
<p>Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p> <p>Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;</p> <p>Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>GVJ gjykon që institucioni përdor të gjithë instrumentat e nevojshëm për të garantuar informimin e plotë të studentëve mbi programet si edhe të gjitha çështjet që ndikojnë mbi ecurinë e tyre akademike, si p.sh afatet e përfundimit, detyrimet që kushtëzojnë vlerësimin e tyre, etj.</p> <p>GVJ vlerëson se fleksibiliteti dhe komunikimi janë përparësi të mënyrës me të cilën institucioni ka organizuar procesin mësimor, në funksion të arritjes së objektivave akademike të programit, në përputhje të plotë me objektivat e formimit të studentëve.</p>
<p>Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Ndonëse UNYT është një institucion modest në aspektin e përmasave të stafit akademik, strukturat e tij janë të mirëorganizuar dhe funksionale, në përputhje të plotë me misionin e institucionit.</p> <p>GVJ konstaton se Zyra e Këshillimit të Karrierës, tashmë e plotësuar dhe tejet aktive, udhëhiqet në veprimtarinë e saj nga interesi më i mirë i studentëve, të cilët përftojnë shërbime cilësore në drejtim të këshillimit, zgjidhjes së problemeve, orientimit në tregun e punës si edhe në ofrimin e mbështetjes për të realizuar praktikën profesionale.</p> <p>Ndonëse studentët e këtij program punojnë gjatë ndjekjes së studimeve, institucioni i ka ngritur strukturat, që mundësojnë realizimin e praktikave profesionale.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p>	
<p>Në përputhje dhe zbatim të metodologjisë së vlerësimit, GVJ pasi analizoi dokumentacionin e nevojshëm, RVB si edhe diskutoi gjerësisht përgjatë vizitës dy ditore në institucion:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Konkludon se institucioni ka ndërtuar struktura dhe përdor instrumenta efektive për të garantuar cilësinë më të lartë të studimeve, në funksion të karrierës profesionale të studentëve; 2. Vlerëson se institucioni vëzhgon me kujdes ecurinë e studentëve përgjatë dy viteve të ciklit të studimeve në Master Shkencor dhe i orienton politikat e tij në funksion të efektivitetit të mësimnxënies; 3. Konkludon dhe rekomandon se institucioni duhet të analizojë më në thellësi të dhënat rreth numrit të 	

studentëve të regjistruar, ndryshimin e tyre ndër vite si edhe raportin ndërmjet studentëve të diplomuar në kohë në krahasim me numrin e përgjithshëm të studentëve të regjistruar.

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Terma reference: politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

GVJ vlerësoi se Politika e Nxitjes së Kërkimit Shkencor në funksion të programit "Master Shkencor", synon rritjen e kapaciteteve dhe intensitetit të kërkimit me anë të prodhimit të botimeve shkencore të cilësisë së lartë. Kërkimi shkencor multidisiplinor mbështetet gjerësisht nga politikat e UNYT duke synuar rritjen e impaktit në shkëmbimin e njohurive në komunitetin shkencor.

Me qëllim ndërkombëtarizimit të kërkimit shkencor, UNYT ka krijuar Zyrën e Kërkim-Zhvillimit/ Zyra e Projekteve. Gjithashtu organizimi i konferencave ndërkombëtare ka qenë në fokus të UNYT i cili në vitin 2018 organizoi një konferencë ndërkombëtare përmes grantit Jean Monnet mbi Demokratizimin dhe Pajtimin Etnik.

Ndonëse pjesëmarrja në konferenca është një nga angazhimet serioze të personelit akademik, institucioni nuk aplikon tregues të veçantë vlerësimi për pjesëmarrje në konferenca apo botime. Megjithatë, ka pedagogë të cilët botojnë deri në 5 punë shkencore në vit (pedagogë të huaj).

Pavarësisht politikës motivuese të zhvillimit të kërkimit shkencor, ngarkesa e lartë mësimore e pedagogëve, që është një fakt i pamohueshëm (ngarkesë mesatare 7 deri 9 orë në javë në auditor, pjesëmarrje në udhëheqje temash, punë administrative etj), kufizon mundësitë e stafit akademik. GVJ gjykon që UNYT duhet të gjejë mekanizma që harmonizojnë punën kërkimore shkencore të stafit, ngarkesën akademike si edhe detyrimet e tjera të tyre ndaj institucionit.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna për kërkimin shkencor

GVJ konstaton se shkalla e rritjes së kërkimit nga një vit akademik në tjetrin është e evidente, me 18 artikuj gjithsej të publikuar dhe 35 pjesëmarrje në konferenca. UNYT ndjek me interes vlerësimet vjetore të rezultateve të kërkimit të prodhuara nga stafi akademik dhe kërkimor. Ekzistojnë pesë shtylla kërkimore së bashku me 16 projekte kërkimore në të cilat kanë kontribuar të gjithë fakultetet dhe studentët.

GVJ gjithashtu vlerëson se të gjithë studentët e diplomuar në Masterin e Shkencave në Administrim - Biznes janë angazhuar në punën kërkimore dhe projektet e drejtuara nga UNYT duke e bërë të dukshëm kontributin e tyre nëpërmjet punës që kanë bërë në punimin e tezave.

Institucioni ka zbatuar në mënyrë aktive politikat kombëtare dhe rajonale të kërkimit shkencor siç shfaqet dukshëm në projektin ADRIATinn, ku UNYT ishte partner dhe u zbatuan politikat rajonale "për avancimin e zhvillimit të kërkimit dhe inovacionit drejt krijimit të politikave të reja për konkurrencë të qëndrueshme dhe kapacitete teknologjike për NVM-të".

Shembulli i dytë në mbështetje të angazhimit në zbatimin e politikave ndërkombëtare është dhe projekti Erasmus+ në të cilin UNYT bën gjithashtu pjesë, qëllimi i të cilit është krijimi dhe mbështetja e proceseve dhe mekanizmave të sigurimit të cilësisë, për të siguruar menaxhim efektiv të mësimdhënies dhe mësimnxënies në institucionet private të arsimit të lartë në Shqipëri.

GVJ, pasi analizoi të dhënat e paraqitura në RVB si edhe informacione të tjera, që rezultuan nga takimet gjatë vizitës në institucion, gjykon që botimi i 61 librave, 117 artikujve në revistat e rishikuara nga ekspertët si edhe 202 pjesëmarrje në konferenca me proceedings, mbështesin vëzhgimin se UNYT konsideron transferimin e rezultateve të kërkimit shkencor si tejet kritik për të ardhmen e institucionit, e për rrjedhojë e konsideron politikë thelbësore nxitjen e:

- Integrimin të studentëve të diplomuar dhe kërkuesve të rinj në grupet kërkimore të UNYT.
- Mbështetjen e aktiviteteve botuese shkencore institucionale, siç është edhe rasti i publikimit të librit të përmbledhjeve për konferencën ndërkombëtare "Tranzicioni në retrospektivë"
- Sigurimit të aksesit të hapur në bibliotekë për të gjitha tezat dhe punët e doktoraturës të prodhuara në UNYT.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disipinën përkatëse;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.</p>	GVJ gjykon që megjithë ngarkesën, personeli përpiqet të publikojë rregullisht artikuj e materiale shkencore, ndonëse ende kjo nuk është e shndërruar në një praktikë.
Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.</p>	GVJ, pasi analizoi dosjet e personelit akademik si edhe diskutoi me stafin përgjegjës për burimet njerëzore, konstatoi se personeli akademik i UNYT karakterizohet nga nivel i lartë kualifikimi. Personeli zotëron njohuri të thelluara të gjuhës së huaj, që e lejojnë atë që të ofrojë mësimdhënie cilësore në gjuhë të huaj, gjë e cila është kërkesë e detyrueshme e UNYT.
Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.</p>	Kualifikimi i stafit akademik është proces i pandërprerë në UNYT. GVJ vlerëson se ky synim arrihet nëpërmjet përdorimit të instrumentave të shumtë e të larmishëm. Pjesëmarrja në projekte bashkëpunimi si edhe nxitja e kërkimit shkencor janë dy mekanizma që ndikojnë ndjeshëm në rritjen e kualifikimit

	profesional të personelit akademik.
Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.</p>	<p>Institucioni ka investuar dhe vazhdon të investojë burime të konsiderueshme për modernizimin dhe përdorimin efektiv të bazës të të dhënave. Kohët e fundit, në sajë të projekteve bashkëpunuese, institucioni ka mundësuar zgjerimin dhe pasurimin e bazës të të dhënave, e cila është e aksesueshme nga të gjithë ata që janë të interesuar të thellojnë njohuritë e tyre si edhe të ndihmojnë në përhapjen e eksperiencave më të përparura. GVJ konfirmon se veprimtaritë themelore të institucionit janë të dokumentuara tek baza e të dhënave, duke lehtësuar përdorimin efektiv të tyre.</p>
<u>Konkluzionet e vlerësimit:</u>	
<p>Mbështetur nëpërshkrimet dhe argumentat e zhvilluara në këtë komponent, GVJ:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Gjykon që Institucioni ka ndërmarrë dhe vazhdon të investojë në hartimin e politikave nxitëse e bashkëkohore për të rritur pjesëmarrjen dhe angazhimin në fusha të ndryshme të kërkimit shkencor. 2. Konstaton që Kërkimi Shkencor dhe rritja e Cilësisë së Mësimdhënies janë dy komponentë të së njëjtës politikë, që në apërfundim shërben për të prodhuar më shumë rezultate për studentët, njohuri të thelluara teorike e praktike. 3. <i>Gjykon dhe rekomandon që institucioni duhet të përshtasë politikat e kërkimit shkencor në funksion të ngarkesës akademike të stafit si edhe të ngarkesës administrative, ose duhet të harmonizojë më mirë këta komponentë.</i> 4. <i>Rekomandon që institucioni duhet të hartojë tregues të vlerësimit periodik për të "matur" kontributin e stafit akademik në zhvillimin e kërkimit shkencor.</i> 	

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

Terma reference: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

GVJ gjykon që institucioni mundohet të nxisë dhe promovojë përmes politikave të veta bashkëpunim ndërsektorial, brenda dhe jashtë vendit, duke zbatuar qasje bashkëkohore e gjithëpërfshirëse. Këtij qëllimi i ka shërbyer edhe zgjerimi e forcimi i Qendrës Kërkimore brenda institucionit, e cila përpigjet të luajë rol aktiv. Megjithatë, ngarkesa e lartë mësimore e stafit akademik si edhe angazhimet e tjera administrative, kufizojnë

mundësitë e stafit për të bashkëpunuar në hartimin e projekteve, e për rrjedhojë rezultatet ende janë larg objektivave të synuara të Qendrës.

Nga dokumentacioni por edhe nga vizita në institucion, dhe takimet me drejtues të fakultetit dhe veçanërisht të qendrës kërkimore vihet re se roli që kjo qendër mund të luajë në nxitjen e kërkimit shkencor, në forcimin e lidhjeve me bizneset/NGO/institucione lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare, pra në rrjetëzimin e marrëdhënieve dhe të bashkëpunimeve, është më i madh se sa ai aktual. Vihet re se infrastruktura në shërbim të kërkimit shkencor është mjaft e mirë dhe mbështetëse për punë individuale, por duhet të ketë politika që të tërheqi sa më shumë staf dhe studentë drejt përdorimit të tyre.

Roli qendrës kërkimore duhet të forcohet dhe aktiviteti i saj duhet të bazohet dhe mbështetet në strategji dhe plane afatgjata. Siç u konfirmuar gjatë vizitës në institucion, ekipi i ri drejtues i UNYT, i ndërgjegjësuar për ngarkesën e lartë të stafit si edhe sfidat e tij të vazhdueshme për të përballuar cilësinë në rritje të mësimdhënies dhe kërkesat e tjera të procesit akademik e administrativ, po konsideron mundësinë e aplikimit të një skeme motivuese për stafin me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së tij në proceset e kërkimit e të zhvillimit si edhe në projekte.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar (ploteso Tabelat ne aneks)

GVJ pasi analizoi të dhënat e dosjes së vetë/vlerësimit si edhe të dhëna të tjera të përgatitura sipas kërkesës të ekipit të vlerësimit të jashtëm, gjatë vizitës në institucion, (shih tabela 20, Aneks) gjykon që informacioni është i kufizuar për të lejuar dhënien e komenteve specifike. Nëse konsiderohen përmasat modeste të aktivitetit të institucionit si edhe numri i kufizuar i personelit akademik dhe administrativ, të dhënat dëshmojnë për një aktivitet të larmishëm e të gjerë bashkëpunimi brenda dhe jashtë vendit. Gjithsesi, të dhënat do të ilustronin më qartë situatën, nëse do të jepnin informacion sipas periudhave specifike kohore.

6 punonjës të UNYT kanë marrë pjesë si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombëtare, ndërsa 143 punonjës, staf akademik i UNYT, kanë marrë pjesë në aktivitete shkencore jashtë UNYT dhe jashtë vendit. Të gjithë pjesëmarrësit kanë prezantuar.

- Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë (plotëso te dhenat ne aneks)

GVJ gjatë shqyrtimit të hollësishëm të RVB por edhe si konkluzion i vizitave të realizuara në periudhën dy ditore në Institucion, konstaton se:

- UNYT i ka kushtuar një rëndësi të veçantë bashkëpunimit me institucionet e tjera brenda dhe jashtë vendit dhe formave të ndryshme të këtij bashkëpunimi, (mësimdhënie, kërkim shkencor, praktika mësimore, etj. [Tabela 21]
- UNYT ka një histori dhe eksperiencë të bashkëpunimit të tij me Institucione të tjera partnere akademike dhe shkencore të huaja. [Tabela 21]
- UNYT ka bashkëpunim nëpërmjet këmbimit të eksperiencave në aktivitete të përbashkëta dhe të veçanta me disa institucione qeveritare.
- UNYT bashkëpunon me komunitetin e biznesit.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Vlerësimi sipas Standardeve


Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.	
<p>Kriteri 1 Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve “Master Profesional”, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;</p> <p>Kriteri 2 Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i Shkencave” ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>	<p>GVJ vlerëson se UNYT për realizimin e qëllimit dhe objektivave të programit Master Shkencor, trajton me prioritet ndërtimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit e të përfitimit reciprok si me operatorët private ashtu edhe me ata publikë, në interes të rritjes së cilësisë të arsimit dhe edukimit të ofruar në këtë institucion, si edhe për mbështetjen e studentëve për ndërtimin e profilit të tyre profesional dhe karrierës.</p>
Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>GVJ gjykon që institucioni nxit dhe orienton bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet aktiviteteve të vazhdueshme informuese dhe shkëmbimit të informacionit, të tilla si prezantime të Punimeve Shkencore në nivel Master dhe PhD, zhvillimi i seminareve informuese/ trajnuese, pjesëmarrjen dhe prezantimin në konferenca, realizimin e projekteve bashkëpunuese, siç ilustron edhe nga të dhënat e paraqitura tek tabela 21.</p>
Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.	
<p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>GVJ konfirmon që jo vetëm për shkak të statusit të UNYT, por edhe si praktikë bashkëkohore, institucioni ka ndërtuar bashkëpunime efektive brenda dhe jashtë vendit, dhe investon në mënyrë të vazhdueshme, në rritjen e tyre, me qëllim që të realizojë misionin e tij.</p> <p><i>Megjithatë, institucioni duhet të përpunojë tregues vlerësimi të matshëm progresivë, për të hartuar politika efektive, të mbështetura në evidenca.</i></p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>GVJ gjykon që institucioni mundohet të nxisë dhe promovojë përmes politikave të veta bashkëpunimi ndërsektorial, brenda dhe jashtë vendit, duke zbatuar qasje bashkëkohore e gjithëpërfshirëse. Gjithsesi,</p>	

institucioni duhet të përdorë më me efektivitet kapacitetet e tij. Për këtë qëllim, GVJ:

1. Gjykon që institucioni nxit dhe orienton bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet aktiviteteve të vazhdueshme informuese dhe shkëmbimit të informacionit.
2. Konkludon që institucioni përdor instrumenta promovimi.

Rekomandon që :

1. *Institucioni duhet të përpunojë tregues vlerësimi të matshëm progresivë, për të hartuar politika efektive, të mbështetura në evidenca.*
2. *Kontributi shkencor, bashkëpunimi dhe arritjet individuale duhet të maten dhe vlerësohen edhe me nivelin e kërkimeve të vlerësuara nga pikëpamja ndërkombëtare, apo me analiza/studime që institucioni ofron në mbështetjen/zhvillimin e ekonomisë shqiptare.*



ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Këshilli i Akreditimit në vendimin e tij nr. 508, ka konstatuar që programi i studimit i përmbush objektivat formues, por ka edhe disa mangësi në realizimin tërësor dhe me cilësi të procesit të formimit të studentëve dhe pajisjes së tyre me dijet dhe shprehitë e nevojshme. Këshilli i Akreditimit ka dhënë disa rekomandime, për të cilat UNYT ka punuar në vazhdimësi për plotësimin e tyre. Plotësimi i rekomandime është si më poshtë:

	Rekomandimet nga akreditimi i mëparshëm	Statusi aktual
a)	Të rritet koha që studentët i dedikojnë kërkimit, zhvillimit personal dhe profesional.	Përmbushur plotësisht
b)	Të ullet ngarkesa mësimore e stafit efektiv meqë është relativisht e lartë.	Përmbushur pjesërisht

II. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).

a. Pika të forta:

- 1) Qasja ndaj vlerësimit duke përdorur instrumenta efektivë të drejtëpërdrejtë dhe të tërthortë, mbështetur në metodologji të institucionalizuar dhe rigorozisht shkencore vlerësimi.
- 2) Ofrimit të studentëve njohuri mbi metodat e kërkimit shkencor të pavarur bashkëkohore, në përputhje me standartet, mbështetur në sigurimin e kushteve për përdorimin e literaturës bazë dhe plotësuese, cilësore, nga autorë dhe shtëpi botuese nga më të spikaturat e fushës së biznesit, të njohura në nivel kombëtar e ndërkombëtar;
- 3) Pajisjen e studentëve me aftësinë për të mbajtur qëndrim analitik të ndërthurur me eksperiencë të rëndësishme praktike;
- 4) Zhvillimin e leksioneve dhe seminareve me metoda e forma didaktiko-pedagogjike moderne e interaktive, duke përdorur gjerësisht prezantimet problemore, analizën logjike e sasiore, analizat krahasuese e kontekstuale, pjesëmarrjen aktive të studentëve në leksione e seminare, debatin e improvizuar, etj;
- 5) Ofrimi i mësimit gjatë fundjavës, gjë që rrit shanset e studentëve për pjesëmarrje.
- 6) Cilësia e lartë në hyrje dhe në përfundim të studimeve, e studentëve.
- 7) Shkalla e lartë e punësimit të studentëve.

b. Pika të dobëta:

- 1) Mungesa e një platforme të re, të gjerë dhe ndërvepruese të sigurimit dhe mbajtjes së cilësisë, të shoqëruar me tregues konkretë për matjen e këtij treguesi.
- 2) Mundësitë e kufizuara të studentëve për të marrë pjesë në projekte kërkimore e shkencore.
- 3) Numri i kufizuar i studentëve.
- 4) Mungesa e analizës mbi arsyet që kanë ndikuar në shpërndarjen e çrregullt të regjistrimeve të studentëve përgjatë viteve.
- 5) Politikat e kërkimit shkencor nuk përshtaten me ngarkesën akademike të stafit si edhe ngarkesën administrative.
- 6) Mungesa e treguesve të vlerësimit periodik për të matur kontributin e stafit akademik në zhvillimin e kërkimit shkencor.
- 7) Niveli relativisht i ulët i përthithjes së projekteve.

c. Mundësitë:

- 1) Drejtimi i ri administrativ i institucionit mund të ndihmojë në hartimin e një politike nxitëse dhe motivuese të kërkimit shkencor, që mbështetet në konsideracionin e ngarkesës së stafit.
- 2) Përdorimi me afektivitet i rrjetit të aktorëve dhe grupeve të interesit.

3) Rritja e kërkesës për ndërkombëtarizimin e programeve akademike.

d. Pengesat:

- 1) Tarifat e larta të shkollimit.
- 2) Ulja e të ardhurave në përgjithësi.

Rekomandime:

1. Të evitohet angazhimi i qoftë dhe në raste të veçanta të personelit akademik që nuk ka gradën "Doktor".
2. Të përcaktohen titullarë modesh personeli akademik të kategorisë "Profesor" për të përmbushur kërkesat e ligjit Nr. 80/2015.
3. IAL të sigurojë të ardhura nga burime të tjera për të rritur qëndrueshmërinë financiare.
4. Institucioni duhet të ndërtojë në të ardhmen një platforme të re, të gjerë dhe ndërvepruese të sigurimit dhe mbajtjes së cilësisë, e shoqëruar me tregues konkret të përmatjen e saj.
5. Institucioni duhet të analizojë më në thellësi të dhënat rreth numrit të studentëve të regjistruar, ndryshimin e tyre ndër vite si edhe raportin ndërmjet studentëve të diplomuar në kohë në krahasim me numrin e përgjithshëm të studentëve të regjistruar.
6. Institucioni duhet të përshtasë politikat e kërkimit shkencor në funksion të ngarkesës akademike të stafit si edhe të ngarkesës administrative, ose duhet të harmonizojë më mirë këta komponentë.
7. Institucioni duhet të hartojë tregues të vlerësimit periodik për të "matur" kontributin e stafit akademik në zhvillimin e kërkimit shkencor. Kontributi shkencor, bashkëpunimi dhe arritjet individuale duhet të maten dhe vlerësohen edhe me nivelin e kërkimeve të vlerësuara nga pikëpamja ndërkombëtare, apo me analiza/studime që institucioni ofron në mbështetjen/zhvillimin e ekonomisë shqiptare.
8. Institucioni duhet të përpunojë tregues vlerësimi të matshëm progresivë, për të hartuar politika efektive, të mbështetura në evidenca.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm

Prof. As. Arlinda Ymeraj

Prof. Dr. Raimonda Duka

J

**SUMMARY ANALYSIS OF RVJ IN ACCORDANCE WITH SWOT METHODOLOGY
(STRENGTHS, WEAKNESSES, OPPORTUNITIES, THREATS).**

a. STRENGTHS:


1. Evaluation approach using direct and indirect effective instruments, based on the institutionalized and relevant scientific methodologies.
2. The provision of contemporary knowledge on the independent research methodologies, in fully accordance with standards, strongly supported by the access to basic and complementary literature of high quality, from well known authors and publishing houses, nationally and internationally;
3. The equipment of students with critical thinking skills intertwined with crucial practical experiences.
4. The development of lectures and workshops, using modern and interactive didactic-pedagogical methods and forms, extensively based on the use of presentations, logical and quantitative analysis, comparative and contextual analysis, and active students participation in lectures, workshops and thematical debates.
5. The delivery of the lectures during the weekend, which considerably impact on the high rate of students' participation.
6. High quality of students, in entrance and by the end of studies.
7. High employment rate of students.

b. WEAKNESSES:

1. The lack of new, holistic and innovative strategy to guarantee the quality, based on performance measurement quality indicators.
2. Limited opportunities of students to participate in research projects.
3. Limited number of students.
4. The lack of analysis on the causes that have influenced the disproportionate students enrollment alongside different years.
5. The Research and Development policies are not appropriate vis-a-vis staff academic and administrative overload
6. The lack of performance indicators vis-a-vis staff contribution with regard to research and studies.
7. The relatively low level of project absorption.

c. OPPORTUNITIES:

- 1) Changing the owner of the institution presents opportunities for new development, especially if proposals regarding more effective human resource management policies, are adopted.
- 2) The effective use of network and stakeholders.
- 3) The increase of demand for the internationalization of the programs



d. THREATS


1. High tuition fees.
2. The diminish of revenues.

Recomandations:

1. *To avoid the engagement of academic staff who do not have a "Doctor" degree even in exceptional cases.*
2. *To appoint as head of modules the academic staff of the category "Professor" to meet the requirements of law no. 80/2015.*
3. *HEI to raise incomes from other sources in order to enhance the financial sustainability.*
4. *The institution should build in the future a new, broad and interactive platform of quality assurance and retention, accompanied by concrete indicators of its implementation.*
5. *The institution should analyze more in depth the data about the number of enrolled students, their change over the years as well as the ratio between the time graduates compared to the total number of enrolled students.*
6. *The institution shall adopt policies of scientific research in view of the academic workload of the staff as well as the administrative workload, or should better align these components.*
7. *The institution should develop periodic evaluation indicators to "measure" the contribution of academic staff to the development of scientific research. Scientific contribution, collaboration and individual achievements should also be measured and evaluated by the level of internationally assessed research or analysis / research that the institution offers to support / develop the Albanian economy.*
8. *The institution should develop measurable progressive performance indicators to develop effective, evidence-based policies.*

External Evaluation Group:

Prof. Asoc. Arlinda Ymeraj



Prof. Raimonda Duka

